



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut



GREEN
CLIMATE
FUND

Udhëzime për përpilim të Projekt-ideve për Fondin e Gjelbër Klimatik (GCF)

OCTOBER 2019

Përmbajtja

Fjalorth i termeve kryesorë **6**

Qëllimi i Udhëzimeve **8**

1. Elementet e domosdoshëm që duhen pasur parasysh para hartimit të Projekt-idesë për GCF **9**

1.1 Përmbledhje rreth GCF: Mbi Fondin e Gjellbër Klimatik **10**

1.2 Ç'mbështet GCF? **10**

1.3 Sa janë financat në dispozicion dhe cilat janë llojet e tyre? **12**

1.2 Cilat janë rolet e aktorëve të ndryshëm? **14**

2. Procesi i dorëzimit **19**

3. Cikli i projektit GCF /hartimi i propozimit **21**

3.1 Si të hartohet dhe të dorëzohet propozimi tek GCF **21**

3.2 Thirrja e Hapur për Projekt-ide për GCF **22**

3.3 Si duhet plotësuar Dokumenti i Projekt-idesë **23**

4. Kontrolli i përshtatshmërisë dhe prioritetizimi strategjik i

Projekt-idesë suaj **37**

4.1 Vlerësimi i Përshatshmërisë së Projekt-idesë **38**

4.2 Prioritetizimi strategjik i projekt-ideve **39**

4.3 Plani indikativ për Vlerësim të Projekt-ideve **40**

Hyrje

Fondi i Gjellbër Klimatik (GCF) është fond i ri global dedikuar çështjeve klimatike i krijuar nga 194 vende, anëtare të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që mbështet përpjekjet e vendeve në zhvillim për të trajtuar sfidën e ndryshimeve klimatike duke investuar në zhvillime afatgjate me emetime të ulëta dhe klimë të qëndrueshme. Financat e përgjithshme momentale të GCF janë 10.3 miliardë USD dhe mobilizimi i resurseve për rikapitalizim të Fondit është në vijim e sipër.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 1997 dhe Protokollin e Kiotos në UNFCCC në 2004. Vendi nënshkroi Marrëveshjen e Parisit në shtator 2016 dhe dorëzoi Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (INDC) për zvogëlim të emetimeve të CO2 nga djegia e karburanteve fosile për 30% ose për 36% me ambicie më të lartë, deri në 2030 në krahasim me skenarin e gjendjes së zakonshme. Vendi ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit në tetor 2017.

Si vend me të ardhura të mesme që është në veçanti i prekshëm nga ndryshimet klimatike, Republika e Maqedonisë së Veriut është e përshtatshme për financim nga GCF dhe për përdorim të programeve mbështetëse që GCF ofron. Në këtë drejtim, me mbështetje teknike nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) e KB, Kabineti i Zëvendës-kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjigjës për Çështjet Ekonomike, ka implementuar projektin “Mbështetja e menaxhimit të një mekanizmi kombëtar efektiv koordinues për Fondin e Gjellbër Klimatik”, financuar në kuadër të programit mbështetës të GCF për Gatishmëri dhe Përgatitje.

Ky projekt është përqëndruar në forcimin e kapaciteteve institucionale të Organit Kombëtar të Emëruar (OKE) që në mënyrë efektive t'i përmbushë rolet dhe përgjegjësitë që ka, duke krijuar proceset e nevojshme kombëtare të pjesëmarrjes dhe proceset e angazhimit të palëve relevante, si dhe duke inicuar përgatitjen e Programit kombëtar Punues për GCF, në përputhje me prioritetet kombëtare për përshtatje dhe zbutje, me Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe me kriteret e GCF për investime.

Si rezultat i këtij projekti dhe në përputhje me përgjegjësitë kryesore si OKE, Kabineti i Zëvendës-kryeministrit të Qeverisë për Çështjet Ekonomike, në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka shpallur Thirrjen e parë të Hapur për dorëzim të Projekt-ideve (Tetor 2019) që trajtojnë sfidën e ndryshimeve klimatike. *Për të lehtësuar hartimin dhe dorëzimin e projekt-ideve, OKE, me mbështetje teknike nga FAO, ka përpiluar këto Udhëzime për aplikantët, që ofrojnë:*

Informata bazë mbi GCF dhe hartimin dhe miratimin e propozim projekteve;

- Udhëzime të hollësishme për Aplikantët për të gjeneruar Projekt-ide për GCF si hap i parë në hartimin e propozim-projekteve për GCF (gjenerim i projekteve) që iu përgjigjen pyetjeve praktike lidhur me atë se si duhet filluar dhe si duhet elaboruar ideja e tyre për të trajtuar çështjet kombëtare mbi zhvillim të qëndrueshëm klimatik dhe ulje afatgjate të emetimeve dhe fushat me rezultate me ndikim të GCF.

Fjalorth i termeve kryesorë

Subjekt i Akredituar (SA): subjekt i akredituar nga GCF në përputhje me Instrumentin Qeverisës dhe Vendimet relevante të Bordit për zbatim të rurseve të Fondit tek vendet në zhvillim.

Përshtatja: përshtatje tek sistemet natyrore ose njerëzore si përgjigje e stimujve momentalë ose të pritur ose efekteve të tyre, ashtu që moderohen dëmet ose eksploatohen mundësitë përfituese

Ndryshime klimatike: ndryshimi në klimë që i atribuohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte aktivitetit njerëzor, që ndryshon kompozimin e atmosferës globale përveç ndryshueshmërisë natyrore të klimës observuar nëpër periudha kohore të krahasueshme.

Koncepti: dokument koncepti i projektit ose programit që ofron informata bazë mbi projektin ose programin për të ofruar informata kthyesë lidhur me atë se vallë koncepti në përgjithësi është në përputhje me qëllimet dhe politikat e Fondit.

Garancat Ekologjike dhe Shoqërore (ESS): mekanizmi për mbështetje të identifikimit, matjes dhe menaxhimit me rreziqet ekologjike dhe shoqërore që rezultojnë nga zbatimi i projektit/programit. ESS të GCF bazohen tek tetë standardet e performancave (PS) të Korporatës Ndërkombëtare të Financave.

Propozim për financim: propozim projekt i përpiluar plotësisht dorëzuar tek GCF për financim. Subjektet e Akredituar kanë qasje tek resurset e GCF për të zbatuar projekte dhe programe lidhur me ndryshimet klimatike duke dorëzuar tek Fondi propozime për financim.

Fondi i Gjelbër Klimatik (GCF): në Konferencën e 16 COP në Kankun në 2010, Qeveritë themeluan Fondin e Gjelbër Klimatik (GCF) si subjekt për funksionim të mekanizmit financiar të Konventës sipas Nenit 11. GCF do mbështesë projekte dhe programe, dhe aktivitete të tjera përgatitore nëpër vendet Anëtare në zhvillim. Ky Fond udhëhiqet nga Bordi i GCF.

Indikator: veçori ose variabël që matet i cili ndihmon përshkrimin e një situate eksiztuese dhe gjurmimin e tendencave ose trendeve- pra përparimin ose progresin që vjen me kalimin e kohës.

Zbutje: tek ndryshimet klimatike, i referohet intervenimit të njerëzve për ulje të burimeve ose rritjes së zvogëlimit të gazrave serrë. Si për shembull përdorimi i karburanteve fosile në mënyrë më efikase, kalimi në energji diellore ose me erë, përmirësimi i izolimit të ndërtesave, dhe zgjerimi i pyjeve dhe mënyrave të tjera për ulje dhe mënjanim të sasive të mëdha të dioksidit të karbonit nga atmosfera.

Organi Kombëtar i Emëruar (OKE): institucion qeveritar i emëruar si pika thelbësore dhe pika kryesore e komunikimit mes vendit dhe Fondit. OKE siguron që aktivitetet e mbështetura nga Fondi, duke përfshirë këtu propozim-projektet, të jenë në përputhje me qëllimet strategjike dhe prioritetet kombëtare, dhe të ndihmojë në përparimin e aktiviteteve ambicioze për

përshtatje dhe zbutje në përputhje me nevojat e vendit. Duke lëshuar letrat e mos-kundërshtimit për propozim projektet, OKE sigurohet që propozim projektet e dorëzuar janë në përputhje me nevojat dhe prioritetet kombëtare.

Zhvendosja e paradigmës: hvendosje thelbësore drejt zhvillimit të qëndrueshëm me karbon të ulët dhe me klimë të qëndrueshme, në përputhje me fushat e rezultateve të rëna dakord me GCF dhe në përputhje me qasjen e udhëhequr nga vendi (Eco Ltd, 2016). Zhvendosja e paradigmës e një projekti është në përputhje me shkallën me të cilën aktiviteti i propozuar mund të nxisë ndikimin që do shkojë përtej investimit që do bëjë zbatimin e projektit. Kjo mund të theksohet përmes sigurimit të detajeve më të hollësishme mbi katër faktorët relevantë:

1. Potenciali i rritjes dhe përsëritjes: propozimi duhet të ilustron se si kontributet që priten nga projekti ose programi drejt rrugëve të zhvillimit me karbon të ulët dhe/ose klimës së qëndrueshme mund të rriten dhe të përsëriten, duke përfshirë këtu edhe përshkrim të hapave që duhen marrë për t'u arritur këto potenciale.
2. Potenciali për njohuri dhe nxënie: duhet theksuar çdo potencial për të krijuar ose forcuar diturinë, proceset ose institucionet kolektive të nxënies.
3. Kontributi drejt krijimit të një mjedisi që ofron mundësi: duhet theksuar qëndrueshmëria e rezultateve që do ndjehet edhe pas përfundimit të intervenimit. Propozimet duhet të shpjegojnë se si masat e propozura do krijojnë kushte të favorshme për pjesëmarrje të qëndrueshme dhe efektive të sektorit privat dhe atij public në zhvillimin me karbon të ulët dhe zhvillimin e qëndrueshëm që shkojnë përtej programit.
4. Kontributi në politikat dhe kornizat rregullative: propozimi duhet të elaborojë mënyrën përmes të cilës projekti/programi do avancojë kornizat nacionale/locale rregullative ose ligjore për të nxitur në mënyrë sistematike investimet në teknologji ose aktivitete me emetime të ulëta, të promovojë zhvillim të politikave plotësuese për emetime të ulëta, dhe/ose të rrisë planifikimin dhe zhvillimin e përgjegjshëm ndaj klimës.

Projekti: një sërë aktiviteteve me qëllim(e) kolektiv(e) dhe rezultate dhe përfundime konkrete që përkufizohen ngushtë për sa i përket shtrirjes, hapësirës, dhe kohës; dhe që janë të matshme, që mund të mbikëqyren dhe që mund të verifikohen.

Dokumenti i Projekt-Idesë: dokument që jep informata bazë mbi projektin ose programin që i dorëzohet OKE si hap i parë gjatë hartimit të propozimit për GCF.

Programi: një sërë nën-projektesh ose fazash individuale që lidhen mes veti, të unifikuar përmes një vizioni gjithpërfshirës, qëllimeve të përbashkëta dhe kontributit për qëllimet strategjike, që do japë rezultate të qëndrueshme për klimën dhe që do ndikojë në mënyrë efikase, efektive dhe në masë të madhe tek fushat e rezultateve të GCF.

Cënueshmëria: shkalla në të cilën një sistem është i prekshëm nga, ose e ka të pamundur të përballohet me, efektet negative të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë këtu ndryshueshmërinë dhe ekstremet klimatike.

Qëllimi i Udhëzimeve

Ky dokument ofron udhëzime praktike për Aplikantët që duan të mësojnë për GCF dhe resurset në dispozicion për të mbështetur propozim projektet për klimë të qëndrueshme dhe ulje të emetimeve; procesin e përpilimit të projektit duke përfshirë të kuptuarit më mirë të hapave dhe kritereve që kërkohen për përpilim të *Projekt-idesë dhe dorëzim të saj tek OKE i Republikës së Maqedonisë së Veriut si përgjigje e Thirrjes së Hapur për Projekt-ide.*

Qëllimi i këtyre udhëzimeve është të ndihmojnë personat ligjorë (Aplikantët e mundshëm) në Republikën e Maqedonisë së Veriut të kuptojnë kontekstin kombëtar të NK në vend, politikën kombëtare të vendit, qëllimet për klimë të qëndrueshme dhe për emetime të ulëta dhe aktivitetet prioritare, në përputhje me kërkesat e GCF.

Cilësia e Projekt-idesë dhe kapaciteti i subjekteve që lehtësojnë iniciimin e propozimeve janë faktorë mjaft të rëndësishëm për garancë të partneritetit të mëtijshëm me Subjektet e Akredituar në përpilimin e Koncepteve më të hollësishëm që rezultojnë në përpilim të Propozim-projekteve cilësore që do i dorëzohen GCF.

Duke e pasur parasysh që procesi i hartimit të vetë Projekt-idesë, me informata të detajuara që në aspektin sasior duhet të jenë “te shkurtra, por shumë të sakta dhe me hollësi të mjaftueshme” nuk është i lehtë, si dhe duke pasur parasysh që kjo është Thirrja e parë e hapur për Propozime që do i dorëzohen GCF, këto Udhëzime u përpiluan për të trajtuar sfidat me të cilat pritet të ballafaqohen aplikantët gjatë procesit.

Këto Udhëzime do u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Cili është misioni i GCF dhe cilat janë llojet e mbështetjes që GCF ofron?
- Kush mund të fitojë financim nga GCF dhe si të fitojmë qasje tek këto resurse?
- Sa është sasia e financimit dhe cilat janë llojet e financimit?
- Cilat janë rolet e aktorëve të ndryshëm gjatë fitimit të qasjes tek resurset e GCF?
- Ç’është akreditimi dhe pse Subjektet e Akredituar kanë rol thelbësor në përpilimin dhe zbatimin e propozimeve?
- Ç’është cikli i projektit të GCF?
- Si të përpilojmë një Projekt-ide për GCF: qasje hap pas hapi
- Si t’ia fillojmë /Si të dorëzojmë Aplikimin?

Ky dokument është hartuar si dokument plotësues për Thirrjen e parë të Hapur për dorëzim të Projekt-ideve tek GCF dhe çdo ndryshim për thirrjet e ardhshme (p.sh. ndryshimet tek sektorët nacionalë prioritare, aktivitetet prioritare për zbutje/përshtatje, etj.) do rezultojë në hartimin e Udhëzimeve të reja të azhurnuara.

- **Versioni elektronik i këtyre Udhëzimeve mund të gjehet në www.greendevopment.mk**

1. Elementet e domosdoshëm që duhen pasur parasysh para hartimit të Projekt-idesë për GCF

1.1 Përmbledhje rreth GCF: Mbi Fondin e Gjelbër Klimatik

GCF është mekanizëm financiar themeluar nga Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), dhe vepron si subjekti operativ për zbatim të Marrëveshjes së Parisit të 2015.

GCF është ndërtuar për të mbështetur vendet në zhvillim për të arritur zhvendosje të paradigmës në rrugët e emetimeve të ulëta dhe qëndrueshmërisë klimatike. Kjo arrihet përmes financimit të projekteve dhe programeve inovative dhe transformative të emetimeve të ulëta (për zbutje) dhe qëndrueshmërisë klimatike (për përshtatje) të zhvilluara nga sektori publik dhe ai privat për të kontribuar në zbatimin e prioriteteve kombëtare mbi ndryshimet klimatike tek vendet në zhvillim.

Zhvendosje e paradigmës do të thotë largimi nga praktikat që nuk janë në përputhje me sfidat e ndryshimeve klimatike. Për sa i përket zbutjes, kjo do të thotë largimi nga ekonomitë që zbatohen tek karburantet fosile, që do të thotë ndryshime më të mëdha afatgjate në sistemet energjetike, industriale dhe të transportit në veçanti.

Shembull: Nëse projekti synon të bëjë më efikas një termocentral që punon me qymyr, nuk do ishte zhvendosje e paradigmës sepse baza e sistemit të energjisë (me karburant fosil, i centralizuar) nuk do ndryshonte. Megjithatë, ndryshimi i sistemit të gjenerimit të energjisë dhe atij të distribuimit në tërësi drejt energjive të ripërtëritshme që janë më të decentralizuara dhe të kontrolluara në nivel lokal, do ishte zhvendosje e paradigmës. Zhvendosjet e paradigmës mund të përfshijnë një ose disa sektorë ekonomikë, madje edhe një ekonomi të tërë lokale ose nacionale.

Trajtimi i sfidave të ndryshimeve klimatike kërkon aktivitete kolektive nga të gjitha vendet, qeveritë, qytetet, bashkësitë, bizneset dhe qytetarët e rëndomtë. Duke premtuar 10.3 miliardë USD deri tani, GCF është fondi më i madh në botë që i dedikohet luftës kundër ndryshimeve klimatike. I ndërtuar si instrumenti kryesor financiar për mobilizim të burimeve të sektorit publik dhe atij privat sipas detyrimeve ndaj UNFCCC, GCF është pika kryesore që trajton nevojat e ngutshme për zbutje dhe përshtatje tek vendet në zhvillim.




Figura 1 ilustron fushat tematike ku vendet mund të kenë qasje në fondet e GCF: përshtatje, zbutje dhe të dy fushat përnjëherësh.

GCF u themelua përmes Marrëveshjes së Kankunit gjatë Konferencës së 16-të të Palëve (COP) në 2010, për të mbështetur vendet në zhvillim në trajtimin e ndryshimeve klimatike duke investuar në zhvillim të qëndrueshëm me karbon të ulët.


1.2 Ç'mbështet GCF?

GCF financon projekte dhe programe për ulje të emetimeve (zbutje) dhe klimë të qëndrueshme (përshtatje) të zhvilluara nga sektori publik dhe ai privat për të kontribuar në prioritetet që vendi ka lidhur me ndryshimet klimatike. Projektet që përfshijnë të dy fushat që do japin rezultate lidhur me zbutjen dhe përshtatjen përnjëherësh janë gjithashtu të përshtatshme për financim nga GCF. Aplikantit të projektit do i kërkohet të dëshmojë ndikimin lidhur me ndryshimet klimatike që propozim projekti i tyre do e ketë për sa i përket zbutjes, përshtatjes ose që të dyjave duke:

- Gjeneruar **ndikim të drejtpërdrejtë** me ulje të emetimeve dhe/ose rritje të qëndrueshmërisë;
- Kontribuar në **zhvendosje të paradigmës** drejt një zhvillimi me emetime të ulëta dhe me klimë të qëndrueshme;
- Mbështetur zhvillimin e **qëndrueshëm**;
- Siguruar që financimi plotëson **kërkesat e pranuesit**;
- Maksimizuar pronësinë **e vendit**;
- Zgjedhur projekte/programe që janë **efikase & efektive**

GCF ka përkufizuar tetë fusha impakti (Figura 2) që do japin përfitime madhore zbutëse dhe përshtatëse për vendin. Gjatë përpilimit të projektit për GCF, aplikanti i projektit duhet të identifikojë se cilën nga fushat strategjike të impaktit projekti i tyre synon (duke pasur parasysh që disa fusha mund të vlejné për një projekt ose program të vetëm).

Figura 2: Fushat strategjike të impaktit sipas GCF (Burimi: përshtatur nga paraqitja vizuale e të dhënave e e GCF)



Shembull: Nëse përpjekjet e projektit për të investuar në qytete më klimë kompatible ndikojnë në uljen e emetimeve në transport me emetim të ulët si dhe nëpër ndërtesa, qytete, industri dhe pajisje, gjithashtu mund të mbështesë edhe përshtatjen, në veçanti duke përforcuar qëndrueshmërinë e personave urbanë dhe bashkësive; dhe duke rritur qëndrueshmërinë e infrastrukturës urbane. Në këtë rast, gjithsej katër fusha impakti mund të jenë relevante dhe duhen identifikuar gjatë procesit të aplikimit. Sigurisht, kjo varet nga qëllimet që projekti ka, nga lloji i aktiviteteve të propozuara nga projekti dhe lidhja që ato kanë si dhe nga përshkrimi i potencialit të impaktit dhe zhvendosjes së paradigmës.

- **Mësoni më shumë për GCF: www.greenclimate.fund**

Pasqyrë e Portfolios së GCF (statusi i tetorit 2019):

111 projekte të financuara (42% projekte për zbutje, 34% për të dy fushat dhe 24% për përshtatje)

310 milionë përfitues (numri i personave që parashikohen të kenë fituar rritje të qëndrueshmërisë klimatike)

1.5 Bilionë tCO₂ të evituar

59% janë projekte nga sektoët publikë

41% janë projekte nga sektorët privatë

- **Gjeni pasqyrë të përgjithshme të portfolios së projekteve GCF këtu: www.greenclimate.fund/what-we-do/portfolio-dashboard**
- **Mësoni më shumë për projektet e financuara nga GCF: www.greenclimate.fund/what-we-do/projects-programmes**

Propozim projektet i përkasin njëres nga katër kategoritë e GCF sipas madhësisë së projektit:

Micro	0-10 million USD
Small	10-50 million USD
Medium	50-250 million USD
Large	>250 million USD

Madhësitë e Projekteve portfolio GCF (statusi nga tetori 2019):

41% (46) nga 111 projekte të aprovuar janë projekte mesatare

31% (34) janë projekte të vogla

15% (17) janë projekte të mëdha

13% (14) janë mikro projekte

1.3 Sa janë financat në dispozicion dhe cilat janë llojet e tyre?

Nga marsi 2017, Fondi ka grumbulluar 10.3 miliardë USD ekuivalente me garanca nga 43 qeveri. Deri tani, kontribuesit më të mëdhenj kanë qenë (në radhitje kronologjike të kontributit): Shtetet e Bashkuara, Japonia, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania. Megjithatë, fonde kanë premtuar edhe shtetet në zhvillim siç janë çile, Kolumbia, Indonezia, Meksika, Mongolia, Panamaja, Peruja dhe Vietnami.

Mjetet financiare

Për të financuar projekte dhe programe, GCF përdor katër mjete financiare: grante, kredi/hua, kapital dhe garanca.

Grantet përfshijnë grante të kthyeshëm dhe të pakthyeshëm. Kreditë përfshijnë kredi të larta dhe kredi koncesionare. Duhet theksuar që mund të bashkohen dy ose më shumë mjete, me më shumë se një mjet që do përdoret nga vetë Fondi për një projekt të caktuar, ose me një mjet të Fondit ose mjetet që do kombinohen me mjete nga burime të tjera financiare.

Mjeti financiar		Përkufizime
Grante	I kthyeshëm	Ngjashëm me kreditë, grantet e kthyeshëm përbëhen nga kontribut që i jepet një institucioni pranues për qëllime të investimit, me pritje të kthimit afatgjat të investimit në kushte të përcaktuara në marrëveshjen për financim. Investitori parashikon rrezikun e dështimit të përgjithshëm apo të pjesërisht të investimit; ata gjithashtu mund të vendosin se vallë do e kërkojnë kthimin e investimit të tyre dhe kur do e bëjnë këtë gjë.
	I pakthyeshëm	Për dallim nga grantet e kthyeshëm, grantet e pakthyeshëm janë transfere standarde që bëhen me para në dorë, mallra ose shërbime për të cilat nuk kërkohet që të kthehen. Kjo shumë është ndihmë e drejtpërdrejtë që dallohet nga ndihma që duhet të kthehet.

Mjeti financiar		Përkufizime
Kredi	Koncesionare	Transferi i resurseve nga njëra palë në tjetrën me marrëveshjen që paratë të kthehen në kushte që janë më të favorshme se kushtet e tregut njihet edhe si hua koncesionare ose e butë. Huaja koncesionare përfshin edhe një component të grantit që mund të kuantifikohet sipas asaj se sa të favorshme janë kushtet e huadhënies ("elementi i grantit" i kredisë).
	E siguruar	Kredia bankare e siguruar paraqet obligim për financim të një borxhi që përfshin edhe të drejtë ligjore mbi mjetet e kredi-marrësit përveç obligimeve të tjera ndaj borxhit. Kjo kredi konsiderohet si e siguruar dhe duhet të jetë e para për tu kthyer nga të gjitha obligimet e tjera të kredi-marrësit, që do të thotë që në rast të bankrotit, kredia bankare e siguruar është e para që duhet paguar para se të gjitha palët e tjera të interesuara të kthejnë mjetet e tyre.
Kapitali		Përmben investim në ndonjë projekt ose mjete për tu ulur borxhi dhe për tu arritur kthim më i mirë i kapitalit.
Garancat		Obligim ku subjekti që garanton merr përgjegjësinë e përmbushjes së obligimeve të huamarrësit para huadhënësit në rast se huamarrësi nuk respekton obligimet që ka ndaj huadhënësit, në këmbim të një tarife. Ata mund të mbulojnë tërë investimin ose një pjesë të tij (garancë e pjesërisht).

REF. GCF (2013) 'Korniza e Modelit Biznesot: Korniza e Menaxhimit me Rezultatet'.¹

Mjetet financiare mund të kombinohen për projekte të caktuara që kërkojnë financim nga GCF.

Shembull: Investimet e Programit financiar nga GCF "Fondi i Qyteteve të Gjelbra" (Nëntor. 2018) do përqëndrohen në infrastrukturën urbane në gjashtë sektorë: objekte me karbon të ulët dhe të qëndrueshme në aspektin klimatik, ujërat dhe ujërat e zeza, mbetjet e ngurta, transporti urban, sistemet komunale të energjisë (ngrohja/ftohja qendrore) dhe ndriçimi rrugor në 9 shtete (duke përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut - Qyteti i Shkupit) duke siguruar zhvillim urban ekologjik. GCF mbështet programin me kredi (73.9 milionë USD) dhe me një grant (25 milionë USD) kurse fondet e tjera janë të bashkëfinancuara (EBRD - kredi 398 milionë USD, contribute vendore 68.2 milionë USD, mjete të siguruar nga donatorë të tjerë 9.1 milionë USD dhe grante ofruar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit rreth 30 milionë USD.

¹ REF. GCF (2013) 'Korniza e Modelit Biznesot: Korniza e Menaxhimit me Rezultatet'. Takimi i Bordit 8-10 tetor 2013, Paris, Pika 4(b) e agjendës. https://www.greenclimate.fund/documents/20182/24937/GCF_B.05_03_-_%20Business_Model_Framework_Results_Management_Framework.pdf/d6e50312-fbbf-4cb4-b96b-a47e47cc6f4d

Pasqyrë e përgjithshme e llojit të mjeteve financiare në Portfolion e GCF (statusi nga tetori 2019):

Gjithsej 111 projekte të financuar, që ofrojnë:

Grante për 45% të projekteve

Kredi për 42% të projekteve


Kapital për 9% të të gjithë projekteve të financuar

Garanca për 2% të projekteve

Përveç mjeteve të lartpërmendura, GCF ofron edhe grante plotësues për përpilim të propozimeve për financim dhe për punën e gatishmërisë dhe atë përgatitore të vendit për tu angazhuar me Fondin.

1.2 Cilat janë rolet e aktorëve të ndryshëm?

Në bashkëveprimin me GCF ka tre aktorë kryesorë që kanë rolet e tyre; përpilimi i një propozimi për tu financuar; dhe, nëse ky i fundit miratohet me sukses, mbikëqyrja dhe menaxhimi i zbatimit dhe përfundimit të projektit.



Burimi: përshtatur nga përshkrimet vizuale nga GCF.

Organi Kombëtar i Emëruar

OKE ose pika e kontaktit është institucioni dhe pika e kontaktit me GCF. OKE /Pika e Kontaktit përpilon programe punuese dhe mbikëqyr hartimin dhe zbatimin e propozimeve. Listën e OKE dhe Pikave të Kontaktit mund ta gjeni në www.greenclimate.fund/partners/countries/nda-directory.

OKE i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kabineti i Zëvendës-kryeministrit për çështje Evropiane

Z. Koço Angjushev

Zëvendës-kryeministër për Çështje Evropiane dhe Koordinim të Sektorëve Ekonomikë

Telefoni: Zyrë +389 2 3114 258/ Zyrë +389 2 3118 022 /Faks +389 2 3221 506

Adresa: Bulevard Illinden nr. 2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Z. Daniel Josifovski

Bashkëpunëtlr i Lartë për përmirësim të procesit këshillimor gjatë hartimit të rregullativave

Telefoni: Zyrë +389 2 3118 022 /Faks +389 2 3221 506

Adresa: Bulevardi Illinden nr. 2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

e-mail: Daniel.josifovski@gs.gov.mk

Znj. Olimpja Hristova Zaevska

Këshilltare e Kryetarit për Ekonomi Ndërkombëtare dhe Zhvillim

Telefoni: Zyrë +389 2 3118 022 /Faks +389 2 3221 506

Adresa: Bulevardi Illinden nr. 2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

e-mail: olimpja.zaevska@vlada.gov.mk

- **Nëse doni të dini më shumë ose keni pyetje lidhur me aktivitetet e GCF, kontaktoni pikat e kontaktit OKE ose vizitoni faqen e internetit të OKE: www.greendevlopment.mk**

Subjekti i Akredituar (SA)

GCF nuk zbaton projektet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Propozimi për financim mund t'i prezantohet GCF nga një Subjekt i Akredituar. Kur një projekt/program aprovohet, SA do sigurohet që projekti zbatohet duke punuar me Subjektet e Zbatimit. Roli i SA është të mbikëqyrë, të menaxhojë, të monitorojë dhe, aty ku mundet, të zbatojë projektet/programet e aprovuar nga GCF. SA mund të jenë publikë ose privatë, dhe ndahen në:

- **Subjekte me qasje të drejtpërdrejtë**, që korrespondojnë me subjekte nën-kombëtare, kombëtare ose rajonale. SQD mund të jenë ministritë e vendit ose agjencitë qeveritare, bankat për zhvillim kombëtar, fondet kombëtare klimatike, bankat komerciale, institucione të tjera, etj.;

dhe

- **Subjekte me qasje ndërkombëtare**, që mund të jenë subjekte bilaterale, multilaterale ose rajonale. Këtu mund të përfshihen agjencitë për zhvillim bilateral (p.sh. Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, GIZ), bankat për zhvillim multilateral (p.sh. Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), agjencitë e Kombeve të Bashkuara (p.sh. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi), bankat për zhvillim rajonal (p.sh. Banka e Afrikës për Zhvillim), organizata ndërqeveritare (p.sh. Fondi Botëror i Kafshëve të Egra), etj.

Termi '**I akredituar**' nënkupton që këto subjekte kanë kaluar akreditim rigoroz nga GCF dhe kanë dëshmuar aftësinë e tyre për menaxhim financiar të projekteve dhe për të mbrojtur projektet e financuar nga rreziqet mjedisore dhe ato sociale. Subjektet marrin akreditimin duke u bazuar në disa kriterë: lloji i subjektit, madhësia e caktuar e projektit që duhet zbatuar dhe rreziqet mjedisore dhe sociale që do rezultojnë nga zbatimi i projektit dhe llojet e aktiviteteve që ata mund të bëjnë.

Subjekte të Akredituar të GCF (shembuj):

Organizata Botërore e Meteorologjisë është subjekt ndërkombëtar, që mund të menaxhojë projekte të vegjël (10-50 milionë USD), ata kanë standarde fiduciare për menaxhim të projekteve dhe ekspertizë dhe kapacitete thelbësore administrative dhe financiare, dhe mund të menaxhojnë Projekte të Kategorisë C (me rreziqe të ulëta mjedisore dhe sociale)..

Projektet/programet e kategorisë C janë ato që përfshijnë aktivitete me rreziqe minimale ose nuk përfshijnë rreziqe dhe/ose ndikime për mjedisin dhe/ose për shoqërinë.

Shembuj: Aktivitete siç janë arsimit dhe trajnimi, shëndetësia dhe planifikimi familjar, ripyllëzimi në shkallë të ulët, planet dhe studimet, shërbimet këshillimore.

Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO) është subjekt ndërkombëtar, që mund të menaxhojë projekte të madhësisë mesatare (50-250 milionë USD), kanë standarde fiduciare në menaxhim të projekteve dhe aktiviteteve thelbësore administrative dhe financiare dhe mund të menaxhojnë projekte të Kategorisë B (me rreziqe mesatare për mjedisin dhe shoqërinë).

*Projektet/programet e Kategorisë B janë ato ku përfshihen aktivitete me rreziqe dhe/ose ndikime të lehta që mund të përmirësohen. **Shembuj:** Aktivitete siç janë efikasiteti energjetik ose industria, përshtatja e kulturave ose bujqësia, të ripërtëritshme të vogla-të mesme, etj.*

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) është akredituar nga GCF, mund të menaxhojë projekte të mëdha dhe me rrezik të madh (Kategoria A) me buxhet mbi 250 milionë USD, banka ka implementuar të gjitha llojet e mjeteve financiare).

Projektet/programet e Kategorisë A janë ato që përfshijnë aktivitete me rreziqe dhe/ose ndikime potenciale të konsiderueshme negative për mjedisin dhe/ose shoqërinë që janë të shumëllojshme, të pakthyeshme ose të pa përjetuara më parë.

Shembuj: Pyllëzimi i shkallës së lartë, projekte bujqësore ose të energjisë së ripërtëritshme, projekte që ndikojnë tek sistemet me ndjeshmëri të madhe, projekte me risistemim të madh, projekte me rreziqe serioze në punë dhe në bashkësi, etj

Pra, është shumë e rëndësishme që të zgjidhet SA sipas kompetencave tematike dhe të merret parasysh përputhja mes Projekt-idesë suaj dhe llojit të kriterëve të akreditimit që SA ka kaluar për tu akredituar nga GCF për sa i përket madhësisë së projektit, llojit të mjeteve financiare dhe kategorisë së rrezikut. Nëse institucioni/organizata juaj nuk është SA por dëshiron të punojë me GCF, mund të lidhni partneritet (në vend që të kërkonti akreditim) me SA për të zbatuar projektin e GCF. Do ju duhet të kërkonti partneritet me subjekt të akredituar gjatë fazës së hartimit të Konceptit.

- **Lista e plotë e subjekteve të akredituar mund të gjehet tek faqja e internetit e GCF (<https://www.greenclimate.fund/how-we-work/tools/entity-directory>).**

Përderisa SA luajnë rolin e menaxherëve të fondit të vendit, **Subjektet Ekzekutive (SE)** kanë për detyrë të zbatojnë aktivitetet e përshtatshme që mbështeten nga GCF nën mbikëqyrjen e SA. Obligimet e SE përkufizohen tek propozimi dhe i përgjigjen SA të tyre respektivë. SE mund të jetë gjithçka që nga institucionet ndërkombëtare multilaterale e deri tek OJQ-të e vogla, varësisht nga struktura e projektit dhe aktivitetet e planifikuara.

SA mund të zbatojnë edhe vetë projektin. Tabela më poshtë bën përmbledhje të funksioneve kryesore të këtyre aktorëve.

Lloji i subjektit	Roll
Organi Kombëtar i Akredituar (OKE)	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Ofron mbikëqyrje strategjike të prioriteteve të vendit</i> • <i>Siguron që propozimi i GCF është në përputhje me prioritetet e vendit</i> • <i>Udhëheq Procedurën e Mos-kundërshtimit dhe lëshon Letrën e Mos-kundërshtimit për propozim projektet/programet e GCF</i> • <i>Organizon takime me plaët relevante kombëtare</i> • <i>Ofron letra nominimi për akreditim të SA kombëtarë</i> • <i>Koordinon dhe miraton Programet e gatishmërisë</i> • <i>Lëshon thirrje për Projekt-ide</i> • <i>Shpërndan informata dhe rrit vetëdijen mes palëve të rëndësishme</i> • <i>Dorëzon në Qeveri propozim-projektet për bashkëfinancim</i> • <i>Harton/azhurnon Programin e Vendit dhe planin e projektit</i>

Lloji i subjektit	Roll
Subjekti i Akredituar /Subjekti Zbatues/ Ndërmjetësuesi	<ul style="list-style-type: none"> • Harton dhe dorëzon propozim projekte/ programe për financim • Mbikëqyr menaxhimin dhe zbatimin e programit (dhe ekzekutimin aty ku vlen) • Monitorim dhe raportim • Shpërndarje dhe administrim i një sërë mjeteve financiare (grant, kredi koncesionare, kapital dhe garanci) • Mobilizim i kapitalit të sektorit privat për tu bashkuar me Resurset e GCF dhe/ose resurset personale
Subjekti Ekzekutiv (SE)	<ul style="list-style-type: none"> • Harton propozim projekte/programe për financim përmes SA • Ekzekuton (zbaton) propozimet për financim • Punon nën mbikëqyrje të SA dhe menaxhim i përgjithshëm (pa nevojë për akreditim)

Në përputhje me udhëzimet e GCF mbi Pronësinë e Vendit dhe udhëzimet fillestare për emërim të OKE dhe mekanizmave koordinativ, Republika e Maqedonisë së Veriut ka krijuar mekanizmat fillestarë për të punuar me Fondin e Gjelbër Klimatik dhe po punon në mënyrë aktive me palë të ndryshme relevante për të siguruar qasje tek fondet klimatike. Mekanizmi koordinues i vendit u krijuar me përfshirje të institucioneve të tjera relevante, me rol të veçantë në procesin e aplikimit tek GCF dhe në procedurën e mos-kundërshtimit.

Organe plotësuese maqedonase (përveç OKE) të përfshirë në procedurën e mos-kundërshtimit të GCF:

Komisioni për Këshillim Strategjik- OKE (OKE-KKS) me përgjegjësitë kryesore si vijon:

- Kontribut në vlerësim të përshtatshmërisë së projektit duke dhënë ekspertizë të caktuar mbi çështjet financiare dhe ato të NK, duke përfshirë edhe aspektet për mundësi të barabarta
- Mbështetje e OKE gjatë vlerësimit të Subjekteve me Qasje të Drejtpërdrejtë (SQD)
- Ndihmë e OKE në koordinim dhe angazhim të palëve relevante
- Prioritetizim i paanshëm i projekteve përmes vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me prioritetet kombëtare
- Kontroll teknik i të gjitha aspekteve të propozim projekteve (konsultë me SËG sipas nevojës), duke përfshirë monitorimin e aspekteve financiare dhe teknike gjatë zbatimit të projektit
- Sigurim që nuk ka përsëritje me aktivitete/projekte të tjera lidhur me NK dhe ndihmë në koordinim të donatorëve për NK

Grupe Punues Sektorial me përgjegjësitë:

- Me kërkesë të OKE-KKS, kontribut në diskutime teknike dhe vlerësime të projekteve duke siguruar informata të duhura (në mënyrë të menjëhershme-ad -hoc)
- Këshillim i OKE-KKS mbi çështje teknike dhe operative lidhur me sektorë të caktuar (transporti, energjia, menaxhimi me ujërat, menaxhimi me mbetjet, bujqësia, pylltaria, natyra & biodiversiteti, menaxhimi me tokën, shëndeti, aspektet gjinore të trashëgimisë kulturore dhe perspektivat e grupeve të cënueshme, etj.)

Këshilli Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (KKZhQ + Grupi Punues Teknik i KKZhQ) dhe përgjegjësitë kryesore:

- Verifikimi i procesit të prioritetizimit në kuadër të Programit Punues të Vendit
- Ndihmë e OKE gjatë koordinimit të palëve të rëndësishme
- Ndihmë e OKE në rritje të vetëdijes mbi NK dhe QZhQ

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut


- Miratim i Programit Final Punues të Vendit
- Miratimi i propozimeve finale për projekte për të lëshuar letrën e mos-kundërshtimit
- Miratimi përfundimtar i Subjekteve të Drejtpërdrejtë të Akredituar që janë rekomanduar për të lëshuar Letër Nominimi për SDA

Të gjithë këto organe mbështesin OKE gjatë tërë procesit të aplikimit të GCF, prioritetizimit dhe vlerësimit teknik, si dhe gjatë hapit të fundit të mos-kundërshtimit para dorëzimit të propozimit të plotë tek GCF për financim.

2.Procesi i dorëzimit

Dorëzimi i projekt-ideve do bëhet online në faqen e caktuar të internetit.

Hapi i parë është regjistrimi. Aplikantët duhet të regjistrohen në sistem përmes plotësimit të formularit për regjistrim. Përdoruesit duhet të japin të dhënat që kërkohen: emri, mbiemri, emaili, numri i telefonit. Pas regjistrimit të suksesshëm, përdoruesit do marrin email me lidhjen e konfirmimit..



Pamja e faqes së regjistrimit

Aplikanti duhet të hapë e-mailin dhe të klikojë lidhjen për të konfirmuar vlefshmërinë e adresës elektronike dhe për të vazhduar procesin e regjistrimit. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, aplikanti mund të plotësojë formularet e caktuar të projektit/programit dhe të dorëzojë idenë që ka.



Shembull i një formulari për aplikim

Pas plotësimit në mënyrë të duhur të të gjitha fushave, aplikanti duhet të konfirmojë dorëzimin e projekt-idesë duke klikuar butonin DORËZO (SUBMIT). Pas dorëzimit, projekt-ideja do i dërgohet OKE dhe aplikantit dhe pastaj do vijojë procesi i vlerësimit. Aplikantit do i dërgohet një e-mail konfirmimi.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, pa dallim nga rezultati, aplikanti do marrë e-mail me dokumentin/letrën e duhur që pranon ose refuzon Projekt-idenë e dorëzuar.

3.Cikli i projektit GCF /përpilimi i propozimit

3.1 Si të përpilohet dhe dorëzohet propozimi tek GCF

Propozimet e financuara kalojnë në proces me disa faza para zbatimit të tyre, Propozimet dorëzohen nga SA të shoqëruara me Letër të Mos-kundërshtimit lëshuar nga OKE, dhe pas kësaj vlerësohen nga Sekretariati i GCF dhe nga Paneli i Pavarur Këshillues dhe në fund miratohen nga Bordi i GCF.

Para përgatitjes së propozimit të plotë, GCF rekomandon që SA të përpilojnë Koncept; ky hap bëhet në mënyrë vullnetare, por paraqet hap shumë të dobishëm që mundëson SA të marrin informata kthyes nga Sekretariati i GCF lidhur me atë se vallë propozimi i tyre përputhet me qëllimet, mandatin dhe kriteret e Fondit për investim.



Burimi: GCF, www.greenclimate.fund

Këto Udhëzime për Aplikantët përqëndrohen vetëm në hapin e parë të përpilimit të propozimit- hartimi dhe dorëzimi i Projekt-ideve sipas kriterëve të Thirrjes së Hapur për Projekt-ide për GCF në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për informata më të hollësishme mbi përpilimin e Koncepteve dhe Propozim-projekteve të plota, ju lutemi vizitoni faqen oficiale të internetit të GCF dhe konsultoni manualin dhe udhëzuesin në vijim:

- **The GCF 101 guide on how to access the Fund explains in detail**

how climate finance ideas are brought to the Fund: www.greenclimate.fund/gcf101/funding-projects/project-funding

- **Manuali i Fondit të Gjellbër Klimatik për Propozime 2017 mund t'ju ndihmojë gjatë përpilimit të propozim projektit për GCF: www.cdkn.org/ep-content/uploads/2017/06/GCF-project-development-manual.pdf**

3.2 Thirrja e Hapur për Projekt-ide për GCF

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Kabineti i Zëvendës-kryeministrit për Çështje Evropiane si OKE i GCF ka shpallur Thirrje të Hapur për dorëzim të Projekt-ideve (Tetor 2019) që trajtojnë sfidën e ndryshimeve klimatike. Thirrja e Hapur ka për qëllim të identifikojë Projekt-ide me potencial për zbutje/përshtatje klimatike për t'u marrë parasysht për dorëzim në GCF për tu financuar

Këshilla lidhur me atë se si duhet lexuar Thirrja dhe si të bëhet identifikimi i projekt-ideve

1. *Lexoni Thirrjen me shumë kujdes dhe nëse keni ndonjë Pyetje, dyshime ose ide drejtojuni stafit përgjegjës të OKE në këtë adresë e-mail Daniel.Josifovski@gs.gov.mk, ose www.greendevlopment.mk;*
2. *Kontrolloni nëse institucioni/organizata juaj plotëson kushtet për të dorëzuar Projekt-ide! Kjo Thirrje është e hapur për çdo subjekt juridik- institucione akademike, organe kombëtare/lokale, ndërmarrje publike dhe private, OJQ dhe subjekte të tjera juridike. Gjeni Partnerët e duhur me të cilët do punoni;*
3. *Njoftohuni me rregullat, mandatin e GCF, si t'iu qaseni fondeve të GCF dhe, më e rëndësishmja, 6 kriteret e investimit që GCF ka dhe fushat/rezultatet strategjike të impaktit të GCF. Vizitoni faqet relevante të internetit të dhëna në këto Udhëzime, sidomos portfolion e GCF për propozim projekte inspiruar nga projekte të suksesshme (<https://www.greenclimate.fund/what-we-do/projects-programmes>);*
4. *Lexoni dhe njoftohuni me strategjitë kombëtare për klimë të qëndrueshme dhe ulje të emetimeve, me politikat dhe kornizën institucionale (cila është strategjia jonë për ndryshimet klimatike, cilat dokumente strategjike janë hartuar dhe miratuar deri tani, cilat sektorë prioritarë me qëllime relevante për zbutje/përshtatje janë përkufizuar dhe lloji i aktiviteteve për zbutje/përshtatje. Projekt-ideja juaj duhet të përputhet me Dokumentet kombëtare strategjike (Komunikimi i Tretë Nacional mbi ndryshimet klimatike dhe Raporti i Dytë Dyvjeçar i azhurnuar mbi Ndryshimet Klimatike) dhe duhet të ndjekë fushat strategjike të impaktit sipas GCF (www.greendevlopment.mk);*
5. *Bëni rishikim të Dokumentit të Projekt-idesë dhe mundohuni ta kuptoni se cilat informata/të dhëna duhet t'i jepni. Gjithmonë duhet të keni parasysht që Dokumenti i Projekt-idesë duhet të ketë vetëm 5 faqe (nuk ka nevojë për detaje, shkruani shkurtimisht, përdorni*

- të dhëna në dispozicion ose theksoni metodologjitë me të cilat planifikoni të merrni të dhënat për hapat e ardhshëm- Konceptin dhe/ose Propozim projektin);
6. Dokumenti i Projekt-idesë duhet të plotësohet saktë, ju lutemi ndiqni udhëzimet e dhëna. Mos harroni të bashkëlidhni të gjitha dokumentet plotësuese që kërkohen;
 7. Merrni parasysh seriozisht dy llojet e kritereve që jepen tek Thirrja që do përdoren gjatë Kontrollit të Përshtatshmërisë të Projekt-idesë tuaj dhe gjatë prioritetizimit strategjik. Kriteret e përshtatshmërisë dhe prioritetizimit do zbatohen tek Dokumenti i i Projekt-idesë plotësuar nga ana juaj, prandaj mundohuni që t'i përgjigjeni secilit kriter. Gjithashtu ato mund t'i përdorni edhe si Listë kontrolluese nëse u jeni përgjigjur të gjitha katrorëve të Dokumentit të Projekt-idesë ashtu siç kërkohet;
 8. Kushtojini vëmendje afateve për dorëzim të Dokumentit të Projekt-idesë (15 dhjetor 2019 - 16:00 h) dhe bëni vetë përgatitjet e nevojshme për të dorëzuar atë në mënyrë elektronike në kohën e duhur (bëni profiling tuaj në www.greendevlopment.mk paraprakisht dhe mos prisni të dorëzoni dokumentin në ditën e fundit, ose akoma më keq, në orën e fundit).
 9. Kërkoni lidhjen e GCF për fazën e dytë SA - përpilimi i Konceptit/ Propozim Projektit duke marrë parasysh shabllonet e GCF, rekomandimet dhe projektet e suksesshme.

3.3 Si duhet plotësuar Dokumenti i Projekt-idesë

Këto Udhëzime do ju ndihmojnë të kuptoni se cilat informata dhe të dhëna kërkohen nga ju si Aplikant për të përpiluar Projekt-idenë tuaj.

Dokumenti i Projekt-idesë përbëhet nga pjesët në vijim:

- I. Informata të përgjithshme mbi projektin
- II. Fokusi klimatik i projektit dhe fushat e rezultateve
- III. Përshkrim i projektit
- IV. Aspektet financiare të projektit
- V. Informata mbi aplikantin
- VI. Dokumente plotësuese
 - I. **Informata të përgjithshme mbi projektin**

Informata të përgjithshme mbi projektin	
Titulli i Projektit:	
Projekt ose Program	<input type="checkbox"/> Projekt <input type="checkbox"/> Program
Kohëzgjatja e projektit (muaj):	

<p>Vendndodhja gjeografike e aktiviteteve të projektit (<i>Ju lutemi, bashkangjitni hartën tek Shtojca</i>):</p>	
<p>Subjekti/et Zbatuese (<i>titulli, lloji i organizatës, adresa, personat për kontakt</i>)</p> <p><i>Ju lutemi, në Shtojcë inkuadroni Listë me të punësuar që do jenë përgjegjës për zbatim të projektit (të veçuar sipas gjinisë dhe arsimimit) për secilin subjekt</i></p>	<p>Titulli:</p> <p>Lloji i organizatës:</p> <p>Adresa:</p> <p>Personi për kontakt:</p> <p>Telefoni/adresa e-mail:</p>
<p>Përvoja të mëparshme në zbatim të projekteve të ngjashëm (<i>me ngjashmëri për sa i përket kompleksitetit, shpenzimeve dhe kohëzgjatjes</i>)</p>	<p><i>Ju lutemi, shkruani të paktën dy projekte të ngjashëm të përfunduar duke dhënë informata për shpenzimet e projektit, qëllimin e projekteve, përfituesin kryesor dhe rezultatet kryesore. Si Shtojcë mund të bashkangjitni Listë Referente me të dhënat më relevante lidhur me përvojat e mëparshme</i></p>
<p>Statusi i projektit:</p>	<p><input type="checkbox"/> Propozim Projekt i plotë</p> <p><input type="checkbox"/> Koncepti</p> <p><input type="checkbox"/> Projekt-ideja</p>

- Zakonisht, emri i projektit/programit vjen në fund të përpilimit të Projekt-idesë, prandaj theksoni “fjalët kyçe” kryesore që reflektojnë idenë tuaj për të krijuar titullin e Projektit/programit;

Shembuj: *Zhvillimi i ujitjes dhe përshtatja e ujitjes bujqësore me ndryshimet klimatike; Programi kornizë për financim të energjisë së ripërtëritshme në; Projekti për mbrojtje të ujërave në.....; Mjetet financiare për qytete me efikasitet energjetik, Rritja e investimeve për ndërtesa publike me karbon të ulët, Menaxhim i integruar i rrezikut për siguri në ushqim dhe jetesë në*

- Identifikoni llojin e Projekt-idesë që keni (a bëhet fjalë për projekt ose program)

Projekt ose Program

Projekti është një seri aktivitesh që kanë për qëllim arritjet e qëllimeve të përcaktuara qartë brenda një periudhe të caktuar kohore dhe me një buxhet të paracaktuar (Komisioni Evropian, 2004).

Shembull: Instalimi i një parku të caktuar me erë ose ndërtimi i ndonjë infrastrukture për ujitje në një zonë të caktuar.

Programi është një grup i projekteve të lidhura mes veti që menaxhohet në mënyrë të koordinuar për të marrë përfitime dhe kontroll që nuk do ishin të mundura nëse menaxhimi bëhej në mënyrë individuale (PMI, 2013).

Programet mund të përmbajnë lloje të ndryshme të elementeve, për shembull investime, formulime të politikave dhe ndërtim të kapaciteteve.

Shembull: Iniciativat që kanë për qëllim rritjen e gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme duke kombinuar formulimin e skemave nxitëse dhe kornizës ligjore me investim në infrastrukturën e rrjetit dhe trajnim të teknikëve do shiheshin si qasje programatike.

Duke pasur parasysh qëllimin për mundësim të zhvendosjes së paradigmës drejt zhvillimit të uljes së karbonit dhe klimës së qëndrueshme, qasjet programatike shihen si me më shumë gjasë për t'u përputhur me këtë, duke trajtuar një numër të pengesave në mënyrë të koordinuar.

3. Përkufizoni kohëzgjatjen e propozuar të aktiviteteve që planifikoni. Periudha kohore duhet të jetë reale dhe duhet të përputhet me llojet e aktiviteteve, njohjen e rrethanave nacionale/rajonale (p.sh., sa kohë i duhet vendimit apo dokumentit të kontrollohet nga organet kompetente), vullnetin e palëve relevante për të marrë pjesë, etj. Është më mirë të evitoni kohëzgjatje të shkurtër të aktiviteteve që janë të varura nga palë të ndryshme relevante.
4. Vendndodhja gjeografike e aktiviteteve të projektit/programit duhet elaboruar dhe hartat (vendndodhjet mikro dhe makro) duhet të bashkëlidhen si Shtojcë.
5. Lista me të gjitha subjektet zbatuese/ekzekutive që do zbatojnë projektin/programin duhet të përpilohet me qëllimin kryesor për të prezantuar ekipin, llojin e organizatës (p.sh., kompani private, departament universiteti, komunë ose ndërmarrje publike komunale, etj.), adresa dhe personat për kontakt me informatat e kontaktit (numri i telefonit, e-mail, etj.). Në Shtojcë, duhet të regjistroni të gjithë personat e planifikuar për të punuar në këtë projekt/program të ndarë sipas gjinisë dhe shkollimit. Kjo Listë duhet të përfshijë të gjithë subjektet e përfshirë.
6. Çdo subjekt zbatues duhet të përpilojë listë me informata mbi projekte tashmë të implementuar (ose projekte që janë në vijim e sipër) me kompleksitet të ngjashëm, shpenzime ose kohëzgjatje të ngjashme me Projekt-idenë që propozohet. Të paktën të dhënat/informatat në vijim shkurtimisht duhet të përfshihen në këtë listë: tituli i projektit/programit, kohëzgjatja e projektit, qëllimi dhe objektivat kryesore, përfituesit kryesorë dhe rezultatet kryesore por edhe shpenzimet e projektit/programit. Mund të jepni të gjitha këto informata tek Lista Referente si Shtojcë duke përfshirë edhe të dhëna të tjera relevante mbi përvoja të ngjashme të mëparshme. Në Dokumentin e Projekt-idesë, mund të jepni vetëm lidhjen tek Shtojca që shpjegon përmbajtjen e Listës Referente.

Këshille: Bëni vetëm një Listë Referente ku do shkruani përvojën paraprake të të gjithë subjekteve zbatues meqë niveli i përvojës dhe aftësive të subjekteve zbatuese/ekzekutive do vlerësohet sipas gjithë konsorciumit zbatues- të gjithë partnerëve).

- Shënoni llojin e dokumentit që keni përgatitur dhe që jeni duke e dorëzuar. Thirrja e parë për Projekt-ide i dedikohet Projekt-ideve. Megjithatë, ju lutemi të keni parasysh që nëse ndonjë subjekt ka hartuar tashmë Konceptin ose Propozim projektin, mund të dorëzohet edhe përmbledhje përmes shabllonit të Dokumentit të Projekt-idesë (duke zgjedhur opsionin e Konceptit ose Projekt-ide e plotë, për t'i dhënë OKE mundësi për të shqyrtuar propozimin. .

Këshillë: Në këtë fazë, përpiloni vetëm Projekt-idenë dhe dorëzoni Dokumentin e plotë të Projekt-idesë. Do ju marrë më pak kohë dhe para dhe do e dini se vallë ideja juaj i plotëson kushtet dhe se a është vërtetuar në Programin Punues të Vendit me projekte potenciale të GCF.

GCF parashikon që procesi i përpilimit të një propozimi të plotë zgjat nga 12 deri në 18 muaj. Një anketë e vitit 2016 me SA tregoi që deri tani përpilimi i propozimeve ka marrë mesatarisht 6 muaj, me nevojë për punë të 2.5 personave/ në vit dhe rreth 150000 USD për përgatitje (Eco, 2016b). Megjithatë, kjo mund të mos mjaftojë për projekte/programme të mesme dhe të mëdha: vetëm përgatitja e studimeve të fizibilitetit mund të marrë nga 6 deri në 12 muaj. Përgatitja e vetë propozimit mund të marrë nga 4 deri 6 muaj shtesë, duke bërë që koha e përgjithshme e nevojshme të arrijë 10 deri 18 muaj. Nevojat kohore dhe financiare varen kryesisht nga madhësia e propozimit dhe lloji i aktiviteteve.

Nëse keni bërë tashmë Konceptin tuaj ose edhe Propozim projektin duke përdorur shabllonet e GCF dhe duke ndjekur kriteret e GCF për investim, mund t'i dorëzoni ato tek OKE. Megjithatë, duhet ta keni parasysh që OKE-s do i duhet të marrë përmbledhje të projektit përmes shabllonit të Dokumentit të Projekt-idesë (duke shënuar opsionin Koncept ose Projekt-ide e Plotë) dhe projekti juaj do duhet të kalojë në fazat e sigurimit të cilësisë si Projekt-ide, pa marrë parasysh se në cilën fazë të hartimit është propozimi juaj.

II. **Fokusi klimatik i projektit dhe fushat e rezultateve**

Fokusi klimatik i projektit dhe fushat e rezultateve	
Fusha ku fokusohet projekti:	<input type="checkbox"/> Zbutje
	<input type="checkbox"/> Përshtatje
	<input type="checkbox"/> Prek të dy fushat

Fushat e rezultateve strategjike të Fondit të Gjelbër Klimatik

(Cila nga fushat e targetuara të rezultateve strategjike të GCF i trajton projekti i propozuar?)

Ju lutemi, etiketoni më të rëndësishmet

Zbutje

Duke ulur emetimet e gazrave serrë:

Qasje në energji dhe gjenerim i energjisë

(p.sh. qasje në sistem brenda rrjetit ose jashtë rrjetit (që i plotëson vetë kërkesat personale për energji), ku energjia gjenerohet nga burime të qëndrueshme të energjisë si p.sh. me diell, erë, ujëra gjeotermale, etj.)

Transport me emetim të ulët

(p.sh. trena me shpejtësi të madhe, sistem i autobusëve të shpejtë, etj.)

Objekte, qytete dhe industri dhe pajisje

(p.sh. ndërtesa të reja dhe të rinovuara me efikasitet energjetik, pajisje me efikasitet energjetik për kompanitë dhe menaxhim i zinxhirit të furnizimit, etj.)

Pylltaria dhe përdorimi i tokës

(p.sh. mbrojtja dhe menaxhimi me pyjet, ujitje bujqësore, trajtim dhe menaxhim me ujërat, etj.)

Përshtatje në ndryshimet klimatike

Duke rritur ripërtëritjen në këto sfera:

Njerëzit dhe bashkësitë më të cënueshme

(p.sh. zbutje e rreziqeve negative lidhur me ndryshimet klimatike, krijimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm, krijim i sistemeve për shërbime të sigurimit, etj.)

Shëndeti dhe mirëqenia dhe siguria e ushqimit dhe ujit

(p.sh. sigurim i ujit të pastër për pije për popullatën, zbatimi i teknologjive për kursim të ujit, etj.)

Infrastruktura dhe mjedisi i ndërtuar

((p.sh. infrastrukturë për mbrojtje nga orteuku dhe orteuku i baltës, sisteme për ajrosje, rrjete të qëndrueshme rrugore, etj.)

Ekosistemi dhe shërbimet e ekosistemit

(p.sh. mbrojtja dhe menaxhimi me ekosistemin, ekoturizmi, etj.)

1. Shënoni nëse propozim projekti/programi synon masa për zbutje, përshtatje ose prek të dy fushat (edhe zbutje edhe përshtatje).

Zbutje: në ndryshimet klimatike, intervenimi i njeriut për të ulur burimet ose për të rritur "uljen" e gazrave serrë. Shembuj të këtyllë janë përdorimi i karburanteve fosile në mënyrë më efikase për proceset industriale ose për gjenerim të energjisë, kalimi në energji diellore ose energji me erë, rritja e izolimit të ndërtesave dhe zgjerimi i pyjeve dhe "ulejve" të tjera për të larguar sasi më të mëdha të dioksid karbonit nga atmosfera.

Shembull: Projekt-ide që ka për qëllim të promovojë investimet në burimet e energjisë së ripërtëritshme (aktivitete që çojnë drejt uljes së emetimeve të gazrave serrë)

Përshtatje: përshtatje tek sistemet natyrore ose njerëzore si përgjigje e stimuljeve ekzistues ose të pritur klimatik ose efekteve të tyre, që modrojnë dëmin ose eksploatojnë mundësitë për përfitim.

Shembull: Projekt-ide që ka për qëllim zhvillimin e një sistemi për paralajmërim të hershëm në zonat e ndjeshme ndaj vërshimeve (aktivitetet do përforcojnë qëndrueshmërinë ndaj vërshimeve).

Kujdes: Projekt-ideja duhet të jetë në përputhje me të paktën një sektor prioritar nacional (të dhënë në Shtojcën 1 të këtij dokumenti)

2. Shënoni të gjitha fushat relevante të rezultateve të GCF që vlejné për idenë e propozim projektit/programit (Ju lutemi shënoni ato që janë më relevantet).

Shembulli 1: Projekti për rritje të investimeve në Ndërtesa publike me karbon të ulët në Bosnje dhe Hercegovinë përqëndrohej vetëm tek fusha e GCF e rezultateve të zbutjes, në veçanti tek Ndërtesat, qytetet, industrinë dhe pajisjet meqë qëllimi kryesor i projektit dhe aktiviteteve të projektit ishte fokusi për zbatim të ngritjes së ndërtesave me karbon të ulët në 430 masa EE dhe RE në ndërtesat publike. Për më shumë hollësi vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/fp051

Shembulli 2: Projekti "Forcimi i qëndrueshmërisë klimatike dhe ndryshimit transformativ në sektorin e bujqësisë në Butan" u përqëndrua në disa fusha të rezultateve të GCF: Shëndetësi, ushqim dhe siguri e ujërave, jetesës dhe bashkësive dhe Infrastruktura dhe mjedisi i ndertuar sepse aktivitetet kryesore të projektit do promovojnë praktikat bujqësore me qëndrueshmëri klimatike, do integrojnë të dhënat e rrezikut nga ndryshimet klimatike në menaxhimin me ujërat dhe tokën për të mbështetur përfituesit e vegjël, dhe do ulin rrezikun dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike- rrëshqitjen e nxitur të dheut gjatë ndodhjeve ekstreme që ndërprejnë qasjen në treg. Për më shumë vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/fp107

Shembulli 3: Programi i Kredive për Konsumim me Efikasitet Energjetik në Mongoli u përqëndrua në dy fusha të rezultateve të GCF: Gjenerim dhe qasje në energji, dhe Ndërtesa, qytete, industri dhe pajisje. Ky program do sigurojë kredi për mjete ngrohjeje me efikasitet energjetik dhe produkte shtëpiake, me pajisje të certifikaura për ngrohje për të arritur të paktën 20% ulje në shpenzimin e energjisë. Përdorimi i financimit me grante do përfshijë mënjanimin e pajisjeve të vjetra për ngrohje dhe shtëpi me efikasitet energjetik, duke kontribuar në përmirësim të sjelljes tek konsumatorët. Për më shumë vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/sap004

I. **Përshkrimi i Projektit /Programit**

Përshkrimi i projektit (maks. 3 faqe)	
Qëllimi i projektit:	
Qëllimet e projektit	(if possible, please define specific objectives related to gender and minorities issues and climate change)
Përfituesi kryesor nga projekti (I drejtpërdrejtë dhe indirekt) të ndarë sipas llojit të cënueshmërisë	
Justifikim i shkurtër i projektit (koherenca dhe përputhja me prioritetet nacionale klimatike të vendit dhe strategjitë e zhvillimit si dhe SDG nacionale)	
Përshkruani shkurt problemin e Zbutjes/Përshtatjes që ky propozim tenton ta trajtojë	(ju lutemi, specifikoni çështjet relevante për grupet gjinore dhe grupet e cënueshme)
Regjistroni aktivitetet e propozuara të projektit për të trajtuar problemet dhe pengesat e identifikuara më sipër që do sjellin deri tek rezultatet e pritura	(Ju lutemi cekni nëse aktivitetet/ proceset e propozuara ose teknologjitë që do realizohen janë inovative. Gjithashtu, jepni shpjegim se si gratë, CSO, akademia, biznesi dhe palë të tjera relevante do përfshihen gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit)

<p>Përshkruani shkurt rezultatet e pritura dhe rezultatet e targetuara në aspektin ekonomik (në EUR), social klimatik/mjedis jetësor dhe gjinor</p>	<p>(p.sh. numri i vendeve të reja të punës të krijuara, tonet e emetimeve të reduktuara të CO2 eq., ndikimi i parashikuar i përshtatjes- përfitues të drejtpërdrejtë/indirektë si % e popullatës së përgjithshme, Si do trajtojë projekti çështjet gjinore dhe çështjet lidhur me grupe të tjera të cënueshme?)</p>
<p>Cekni nëse ka potencial për përsëritje të aktiviteteve të projektit në ndonjë rajon ose vend fqinj dhe përdorim të rezultateve të projektit</p>	
<p>Shpjegoni se pse projekti ka nevojë për financim:</p>	<p>(p.sh. shpjegoni pse kjo nuk financohet nga burime të vendit nga sektori/ët publik/ë/privat/ë)</p>

Kjo pjesë është pjesa thelbësore e Dokumentit të Projekt-idesë. Qëllimi i saj është të jepet konteksti më i gjerë dhe një pasqyrë e përgjithshme e idesë së projektit ose programit dhe si i trajton pyetjet në vijim: **pse** projekti/programi ka kuptim në një kontekst të caktuar, **cili** është problemi që do trajtohet dhe rezultatet e pritura nga aktivitetet, **si** mendohet që të arrihen qëllimet lidhur me ndikimet dhe rezultatet dhe lidhur me kohën e planifikuar për aktivitetet

Këshillë: Dokumenti i Projekt-idesë ju kërkon një përshkrim informativ të shkurtër por të mjaftueshëm në formë të strukturuar. Duhet të jepni argumente bindëse prandaj informatat duhet të kenë linjë të qartë argumentuese se si informatat e futura dhe aktivitetet pritet që të sjellin rezultate dhe impakte. Ju lutemi të keni parasysh që keni rreth 3 faqe për të bërë përshkrimin e gjithë kësaj duke përdorur supozime realiste cilësore dhe sasiore (supozime preliminare).

1. Përshkruani shkurt qëllimin e projektit/programit

Këshillë: Qëllimi i Projekt-idesë duhet të jetë në përputhje me sektorët prioritarë nacionalë me potencial të lartë për zbutje/përshtatje. Qëllimi i projektit përshkruan ndikimet nga projekti: efektet afatgjate që duhet të shkaktojë. Zakonisht, qëllimi përshkruhet me fjalët “Ky projekt do kontribuojë në përmirësim të... /do ndihmojë në trajtim të sfidës që qytetet kanë në ballafaqimin me ndryshimet klimatike ...” e të ngjashme, që përshkruajnë vizionin.

Ju lutemi, kontrolloni vallë Projekt-ideja juaj dhe qëllimi i saj mbështesin qëndrueshmërinë klimatike ose përmirësimin e uljes së emetimeve (ose që të dyja) në të paktën një sektor prioritar (më shumë detaje tek Shtojca 1):

Sektorë prioritarë me potencial të lartë për zbutje ²	Sektorë prioritarë me potencial të lartë për përshtatje ³
EEnergjia – Industrinë e energjisë Energjia – Prodhim dhe ndërtim Energjia – Transport	Burimet e ujit
Bujqësia dhe Pylltaria dhe përdorimi tjetër i tokës (AFOLU) – Bagëtia/Pylltaria/Përdorimi i tokës	Bujqësia – E përgjithshme / vreshtaria/ prodhimi i bagëtisë
Mbetjet – Hedhje e mbeturinave të ngurta	Biodiversiteti Shëndeti njerëzor Trashëgimia kulturore

2.Përkufizoni qëllimet e projektit/programit dhe, nëse është e mundur dhe e përshtatshme, përkufizoni qëllimet specifike lidhur me çështjet gjinore dhe të grupeve të cënueshme dhe ndryshimeve klimatike

Këshillë: Para përkufizimit të qëllimeve të projektit/programit, ju lutemi shihni qëllimet prioritare për zbutje/përshtatje tashmë të miratura në dokumentet strategjike të dhëna tek Shtojca 1. Duhet të siguroheni që ideja juaj është në përputhje me sektorin prioritar nacional, me qëllimet prioritare dhe aktivitetet për zbutje/përshtatje. Projekt/programi mund të ketë më shumë se një qëllim meqë këto propozime të financuara nga GCF janë komplekse, çojnë drejt ndryshimeve afatgjata dhe disa qëllime duhet të kombinohen së bashku.

Shembull: Një Projekt-ide e mirë i takon sektorit prioritar (p.sh. Energjia-Industrië e energjisë) qëllimi kryesor i të cilit është të kontribuojë në kalimin drejt burimeve të energjisë me emetim të ulët. Qëllimi i zbutjes është të rrisë kapacitetin shtëpiak të gjenerimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe aktiviteti kryesor i saj është ndërtimi i centraleve me biomasë dhe të fusë në përdorim tarifaf fleksibile premium për të stimuluar ndërtimin.

2 Raporti i dytë dyvjeçar i azhurnuar mbi ndryshimet klimatike (2017) <http://klimat-skipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b0db60ed-b04522ec50e97d2881f1ef56eec77c5090.pdf>

3 Komunikimi i Tretë Kombëtar mbi Ndryshimet Klimatike (2013) http://unfccc.org.mk/content/Documents/TNP_ANG_FINAL.web.pdf

3. Jepni informata dhe të dhëna mbi përfituesit kryesorë nga projekti/programi (të drejtpërdrejtë dhe indirektë) të ndarë sipas llojit të cënueshmërisë

Këshillë: Mendoni për të gjithë përfituesit nga rezultatet e projektit/programit. Regjistroni të gjithë në kontekst të gjerë dhe në periudhë më të gjatë kohore për të identifikuar se cilët ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe cilet në mënyrë indirekte nga rezultatet e Projektit. Gjithmonë prezantoni numrin e përfituesve si përqindje të të gjithë popullatës në vendndodhjen e projektit.

Shembull: Numri absolut i përfituesve ka vetëm vlerë që kufizohet në dhënie të informatës. 10000 përfitues do jenë grup thelbësor i synuar në popullatë prej 100000 por është i parëndësishëm si numër aty ky popullata e përgjithshme është 20 milion.

Shembull: Vlerat duhet gjithashtu të jepen edhe sipas gjinisë, dhe sipas mundësisë të ndahen sipas llojit të cënueshmërisë. Projekti për Ndërtesa publike me karbon të ulët në Bosnje dhe Hercegovinë ka identifikuar përfituesit kryesorë të projektit si 150000 njerëz – banorë dhe shfrytëzues të ndërtesave publike (4% e popullatës së përgjithshme), duke përfshirë këtu 80000 gra.

Duhet ta keni parasysh që GCF kupton dallimin mes shteteve për sa i përket madhësisë, numrit të popullatës dhe shkallës së masave për klimë të qëndrueshme dhe zbutjes në secilin shtet. Prandaj duhet gjithmonë të keni parasysh kontekstin e vendit tuaj dhe të shpjegoni thelbin duke dhënë informata adekuate për të kuptuar më mirë gjendjen.

4. Arsyetim i shkurtër i projektit (koherenca dhe përputhja me prioritetet nacionale klimatike të vendit dhe strategjitë për zhvillim si dhe QZhQ kombëtare).

Këshillë: Analizoni kontekstin e politikave dhe elaboroni shumë shkurt se si ideja e projektit/prgramit do mbështesë politikat dhe strategjitë klimatike të vendit (mund të cekni dokumentet e politikave, QZhQ prioritarë dhe sa QZhQ do ndikohen ose nxiten nga zbatimi i projektit. Meqë Republika e Maqedonisë së Veriut është Vend Kandidat për në BE, ju lutemi, elaboroni se sa kapituj të bisedimeve me BE, ose sa qëllime të BE-së mund të plotësohen duke zbatuar këtë projekt.

Informata të dobishme: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar vendimin që jep u prioritet katër QZhQ për periudhën 2019 - 2020, kurse QZhQ të tjera do i nënshtrohen këtyre QZhQ prioritarë:

- Dhënia fund e varfërisë në çdo formë, gjithkund në vend (QZhQ 1)
- Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës, të barabartë dhe cilësor dhe promovimi i mundësive të përhershme të nxënies (QZhQ 4),
- Promovimi i rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike,

punësim i plotë dhe produktiv dhe vende të mira pune për të gjithë (QZhQ 8)

- Ndërmarrja e aktiviteteve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre (QZhQ 13),
- Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurim i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në çdo nivel (QZhQ 16).

Shembull: *Një ide për projekt/program në sektorin e Ujërave aktivitetet kryesore të të cilit bëjnë modifikim të sistemeve për furnizim me ujë dhe sistemeve të ujitjes për të ulur humbjet e ujërave (pajisje matëse, pikë-pikë, mikro-sprej, me energji të ulët) përkon me disa dokumente të politikave strategjike: Komunikimi i Tretë mbi Ndryshimet Klimatike për Republikën e Maqedonisë së Veriut, Strategjinë Nacionale për Ujërat, Strategjinë Nacionale për Efikasitet Energjetik. Do mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë QZhQ 13 dhe QZhQ 8. Ndryshimet afatgjata në sektorin e ujërave/praktikën e ujitjes do mbështesin gjithashtu edhe QZhQ 1 dhe do jenë në përputhje me qëllimet e reja të BE-së (ulja e humbjeve të ujërave, përmirësimi i praktikave bujqësore, krijimi i vendeve të punës, etj.*

5. Përshkruani skenarin bazë (d.m.th. baza e emetimeve, baza e cënueshmërisë klimatike, pengesat thelbësore, sfidat dhe/ose politikat), rezultatet dhe ndikimin që projekti/programi do synojë të arrijë në përmirësimin e skenarit bazë.

Shembull: *Projekti Ndërtesat publike me karbon të ulët në Bosnje dhe Hercegovinë ka për qëllim të ulë emetimet nga ndërtesat e sektorit publik në Bosnje dhe Hercegovinë përmes një efikasiteti më të madh energjetik dhe përmes zëvendësimit të karburantit nga karburantet fosile në biomasë.*

Bosnja dhe Hercegovina ka një numër të madh ndërtesash të vjetra që harxhojnë shumë energji duke u ngrohur përmes karburanteve fosile me emetime të larta. Kjo ka ardhur si rezultat i neglizhencës dhe mos-investimit gjatë dhe pas luftës së Bosnjës (1992-1995), që ka lënë ndërtesat në nevojë urgjente për rinovim.

Ngritja e efikasitetit energjetik dhe zëvendësimi i qymyrit dhe karburantit fosil me biomasë në masë të lartë do ulë emetimet nga ndërtesat publike. Projekti do ndikojë në 7-8% të numrit të përgjithshëm, rreth 450 ndërtesa publike. Ndiqma teknike gjithashtu do ndihmojë në trajtimin e pengesave jo-financiare dhe në krijimin e politikave mbështetëse, rregullativave dhe kapaciteteve që do ndihmojnë transformimet dhe do inkurajojnë përsëritjen.

3. Regjistroni aktivitetet që propozon projekti për të trajtuar problemet e mësipërme dhe pengesat e identifikuar që do çojnë drejt rezultateve të pritura

Këshillë: *Bëni një listë të aktiviteteve të përshtatshme me rrethanat e vendit tuaj, që bazohet në analizën e situatës fillestare (bazë). Mund të përdorni informata nga vlerësimet ekzistuese për vendin/rajonin e planifikuar ose në nivel komunal, për shembull, vlerësimi i nevojave lidhur me teknologjinë. Konsultat me palët relevante si dhe studime hulumtuese për vende të tjera të ngjashme me tuajin, mund të mbështesin idetë që ju keni. Duhet zgjedhur aktivitetet e qëndrueshme dhe që mund të zbatohen dhe duhen identifikuar rreziqet dhe ndikimet ndaj mjedisit dhe shoqërisë.*

Ju lutemi të cekni nëse aktivitetet/proceset ose teknologjitë e propozuara për tu realizuar janë inovative. Gjithashtu, shpjegoni se si gratë, CSO, sfera akademike, biznesi dhe palë të tjera do përfshihen në zbatimin e aktiviteteve të projektit.

4. Përshkruani shkurt rezultatet e pritura dhe rezultatet e synuara ekonomike (në EUR/USD, nëse keni në dispozicion), sociale klimatike/mjedisore dhe gjinore

Shembull: Projekti për Ndërtesa publike me karbon të ulët në Bosnje dhe Hercegovinë është në përputhje me Planin Nacional të Veprimit të BH për Efikasitet Energjetik

(NEEAP). Ky dokument përmban qëllim indikativ të kursimit energjetik prej 9% deri në 2018 pra, me zbatim të këtij projekti, përmirësimi i efikasitetit energjetik nëpër ndërtesa pritet të japë kontributin më të mirë drejt arritjes së këtij qëllimi, me ulje vjetore në konsumin e energjisë prej 1,900 GWh., dhe gjithsej 2,019,976 tCO₂ gjatë jetëgjatësisë së projektit.

Rezultatet që priten nga zbatimi i këtij projekti shprehen si 100,999 tCO₂ i ulur ose i evituar dhe 150,000 përfitues të drejtpërdrejtë të planifikuar. Ky projekt do çojë drejt krijimit të 5,630 vendeve të reja të punës me orar të plotë.

Përsëritja e aktiviteteve të këtij projekti ka potencial për tu zbatuar në të gjitha komunat e BH, por me potencial të ulët në përfshirje të ndërtesave historike meqë kjo do kushtojë shumë më shtrenjtë.

Këshilla: Indikatorët thelbësorë të dakorduar në GCF, një për zbutje dhe një për përshtatje

- **Zbutje:** *Tonet e ekuivalentit të dioksid karbonit (t CO₂) që priten të ulen ose evitohen*
- **Përshtatje:** *Numri i përgjithshëm i përfituesve të planifikuar të drejtpërdrejtë ose indirektë, të ndarë sipas gjinisë (ulje e cënueshmërisë ose rritje e qëndrueshmërisë); numri i përfituesve relativ me popullatën e përgjithshme, ndarë sipas gjinisë*

Zbutja ndahet më tutje në dy metoda të tjera matjeje: a) Ulje e emetimeve

vjetore të GS që lidhen me ruajtjen nga emetimet në vit; b) Ulje e përgjithshme e emetimeve të GS. Këtu, uljet kumulative të emetimeve gjatë një periudhe kohore planifikohen (përgjatë jetëgjatësisë së projektit/programit).

Indikatorë plotësues të rezultateve nga zbutja mund të jenë: a) Numri i rregullativave/politikave të prezantuara/përshtatura për të trajtuar planifikimin e uljes së emetimeve dhe zhvillimin, b) Numri i furnizuesve të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj me energji, c) Numri i familjeve, grave dhe burrave me qasje më të mirë drejt burimeve të energjisë me emetim të ulët, ç) instalimi, gjenerimi dhe/ose rehabilitimi si rezultat i mbështetjes nga GCF i MW të kapaciteteve të energjisë me emetim të ulët, d) Kursimi/intensiteti i energjisë nëpër ndërtesa, qytete, industri dhe pajisje, , dh) Numri i pasagjerëve plotësues femra dhe meshkuj që do përdorin transportin publik me karbon të ulët, e) hektarë tokë ose pyje nën menaxhim të përmirësuar që kontribon në ulje të emetimeve.

Indikatorë plotësues të rezultateve nga përshtatja mund të jenë: Numri i institucioneve kyçe të synuara ku evidentohet kapacitet i forcuar dhe mekanizma koordinues për klimë të qëndrueshme, b) Numri i rregullativave/politikave efektive të prezantuara/përshtatura për të trajtuar rreziqet e ndryshimeve klimatike, c) Numri i produkteve të gjeneruara informative përshtatur për vendimmarrësit, ç) Masa me të cilën familjet e cënueshme, bashkësitë, bizneset dhe shërbimet e sektorit publik përdorin mjetet që sigurohen nga Fondi, pajisjet, strategjitë dhe aktivitetet për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe ndryshueshëmrinë, d) Numri i sistemeve për paralajmërim të hershëm dhe masa të tjera për ulje të rreziqeve të themeluara/forcuara, dh) Numri i grave dhe burrave që kanë vetëdije të lartë për kërcënimet klimatike dhe përgjigje relevante të duhura

IV. Aspektet financiare të projektit

Aspektet financiare të projektit	
Shpenzimet indikative të përgjithshme të projektit (EUR):	
Kërkesa indikative e financimit nga GCF (EUR):	
Bashkëfinancimi i paraparë (nëse ka) – EUR osë % e shpenzimeve të përgjithshme të projektit	
Lloji i instrumentit financiar që do kërkohet:	<input type="checkbox"/> Grant <input type="checkbox"/> Kredi/hua <input type="checkbox"/> Tjetër
Burime të tjera financiare që pjesërisht do mbulojnë shpenzimet e përgjithshme të projektit:	

Në këtë Pjesë duhet të bëhet paraqitja e aspekteve financiare të projektit/programit. Shpenzimet e përgjithshme indikative (të dhëna me EUR/USD) për zbatim të aktiviteteve të propozuara (tentative), duhet cekur shuma financiare që kërkohet nga GCF, burime të tjera financiare që pjesërisht do mbulojnë shpenzimet e përgjithme të projektit/programit. Duhet të regjistrohet ose shtohet lloji i mjetit financiar që kërkohet nga GCF..

V. Informata mbi aplikantin

Edhe kjo pjesë duhet plotësuar saktë me detajet që kërkohen.

Edhe kjo pjesë duhet plotësuar saktë me detajet që kërkohen.	
Emri i organizatës/institucionit aplikues(e):	
Lloji i organizatës/institucionit: (publik (qeveritar), biznes, OJQ, organizatë ndërkombëtare, institucion akademik, etj.)	
Adresa: (rruga, numri, kodi postar)	
Personi për kontakt:	
Pozita:	
Kontakti (telefoni dhe e-mail):	
Data e dorëzimit të Projekt-idesë për shqyrtim nga OKE	


Informata të dobishme: Aplikantët duhet të përdorin versionin elektronik të Dokumentit të Projekt-idesë dhe këtë mund ta plotësojnë online (Formulari për aplikim Online) duke përdorur profilin dhe fjalëkalimin e tyre për qasje. Pas procesit të regjistrimit, përdoruesi do shohë panel me formularin e paracaktuar (Dokumenti i Projekt-idesë). Pas dorëzimit të Dokumentit të Projekt-idesë, aplikanti do marrë një e-mail me konfirmim që dorëzimi i Dokumentit të Projekt-idesë ka qenë i suksesshëm.

Udhëzime të hollësishme për plotësim të këtij shablloni dhe informata të tjera mbi aktivitetet e Fondit të Gjelbër Klimatik mund të gjeni në: www.greendevopment.mk

4.Kontrolli i përshtatshmërisë dhe prioretizimi strategjik i Projekt-idesë suaj

Në përgjithësi, hartimi i propozimit për GCF prezantohet sipas figurës në vijim ku Faza 1 është përgatitja e Projekt-idesë. Projekt-idetë e miratuara (me kontroll administrativ dhe të përshtatshmërisë, prioretizim strategjik) zhvillohen më tutje në Koncepte (me mbështetje menaxheriale dhe teknike nga SA) dhe pas përgatitjes së studimeve të fizibilitetit, planit të veprimit për gjinitë, studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe shoqëri, analizës së shpenzimeve dhe përfitimeve, dhe dokumenteve të tjera relevante, zhvillohen në Propozim-projekte të plota (duhet të përdoren shabllone zyrtare të GCF, në dispozicion tek faqja zyrtare e GCF: www.greenclimate.fund).

Vlerësimi teknik është i nevojshëm për vlerësim të cilësisë së propozimit lidhur me kriteret e GCF për investim (potenciali i ndikimit, zhvendosja e paradigmës, potenciali i zhvillimit të qëndrueshëm, përgjegjshmëria ndaj nevojave të përfituesit, promovimi i pronësisë së vendit dhe efikasiteti dhe efektiviteti). OKE do lëshojë Letër të Mos-kundërshtimit pas kontrollit përfundimtar të mos-kundërshtimit dhe SA që është përgjegjës për Propozim Projektin do e dorëzojë atë bashkë me dokumentet plotësuese në Sekretariatit e GCF.



4.1 Vlerësimi i përshtatshmërisë së Projekt-idesë

Para dorëzimit të Dokumentit të Projekt-idesë, ju lutemi lexoni Projekt-idenë edhe një herë dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim (është mirë t'i kërkonti dikujt që nuk është përfshirë në përpilimin e Projekt-idesë ta lexojë atë dhe t'i përgjigjet këtyre pyetjeve):

- A janë qëllimet e Projekt-idesë në përputhje me politikat dhe strategjitë nacionale lidhur me klimën?

PO / JO

- A është Projekt-ideja në përputhje me indikatorët relevantë nacionalë për zhvillim, që mundësojnë krijim të kornizave të politikës dhe ato institucionale?

PO / JO

A është Projekt-ideja në përputhje me të paktën një nga tetë fushat strategjike të rezultateve sipas GCF? **PO / JO**

- A trajton Projekt-ideja çështje relevante me integrimin e grupeve gjinore dhe grupeve të tjera të cënueshme dhe a përshkruan se si qëndrueshmëria/zbutja e ndryshimeve klimatike në mënyrë të barabartë ndikon tek burrat dhe gratë ose a sigurohet që gratë do përfitojnë në mënyrë të barabartë nga aktivitetet e projektit?

PO / JO

Këshillë: Para së të bëni dorëzimin, ju lutemi kontrolloni vallë informatat që keni dhënë në Dokumentin e Projekt-ideesë u përgjigjen të gjitha pyetjeve pozitivisht. Vetëm projekt idetë që plotësojnë kushtet do pranohen dhe përfshihen si pjesë e Programit Punues të Vendit të Maqedonisë së Veriut për GCF. Aplikantët e Projekt-ideve të pranuar do inkurajohen që të zhvillojnë më tutje idetë e tyre në Koncepte sipas shablloneve të GCF dhe në konsultim më përfaqësues të OKE.

4.2 Prioretizimi strategjik i projekt-ideve

Kriteret në vijim do përdoren gjatë prioretizimit strategjik të të gjitha projekt-ideve që plotësojnë kushtet:

Kriteret	Description of the criteria	Indicator
Qasja e Projektit	Përshkrimi i formulimit të problemit dhe arsyetimi i aspektit klimatik, qëllimet e aktiviteteve kryesore të projektit dhe rezultatet që priten. Koherenca mes problemeve/ pengesave dhe rezultateve që priten.	Përshkrim koherent i problemit dhe arsyetimi në aspektin klimatik, qëllimet e projektit dhe rezultatet që priten (niveli i koherencës dhe të dhëna relevante të përfshira në projekt-ide).
Kapaciteti i subjekteve zbatues të projektit	Përshkrimi i aftësive relevante të menaxhimit dhe organizimit i subjekteve zbatues/partnerëve në zbatimin e projektit	Përvoja dhe aftësitë e subjekteve/partnerëve zbatues (ky indikator vlen për të gjithë konsorciumin zbatues- të gjithë partnerët)
Kohëzgjatja e parashikuar e projektit	Koha e përkufizuar e aktiviteteve të propozuara të projektit	Korniza kohore që tregon kohëzgjatjen e aktiviteteve që propozohen
Statusi i projekt-idesë	Identifikimi i nivelit të zhvillimit të projekt-idesë (faza e hershme, koncept i përpiluar/propozim projekt i plotë)	Statusi momental i projekt-idesë/shkalla e zhvillimit
Potenciali për të mbështetur procesin nacional të pranimit në BE	Përshkrimi se si dhe në çfarë mase qëllimet e projektit dhe aktivitetet që planifikohen mbështesin rrugën e vendit drejt pranimit në BE dhe ndihmojnë në arritje të kriterëve të BE-së	Numri i kërkesave të BE që do plotësohen përmes zbatimit të projektit dhe ndikimit të tij
Qëllimet e Projektit në përputhje me QZhQ nacionalë prioritarë	Elaborim lidhur me atë se si qëllimet e projektit përputhen me QZhQ	Numri i QZhQë që do ndikohen ose nxiten nga zbatimi i projektit
Koherenca me strategjitë nacionale mbi ndryshimet klimatike	Përshkrimi i pronësisë së vendit dhe kapaciteti për të zbatuar projekt apo program të financuar (politikat, strategjitë klimatike dhe institucionet)	Koherenca dhe përputhja e qëllimeve të projektit me prioritetet tashmë të trajtuara në politikat dhe strategjitë nacionale lidhur me klimën
Potenciali i ndikimit (Vlerësim preliminar)	Potenciali i projektit për të kontribuar në masë të madhe në uljen e emetimeve ose në rritjen e qëndrueshmërisë (vlerësimi preliminar). Specifikoni ndikimin nga zbutja dhe/ose përshtatja duke dhënë qëllime nacionale të krahasueshme	Vlerësim preliminar i potencialit të zbutjes (tCO ₂ eq gjatë jetëgjatësisë së projektit). Vlerësimi preliminar i potencialit të përshtatjes (numri i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe indirektë si përqindje nga popullata e përgjithshme). Barazia gjinore dhe potenciali i grave dhe burrave veç e veç si dhe i grupeve të cënueshme


E rëndësishme:

Cilat Projekt-ide marrin më shumë pikë?

- Projekt-idetë me shpjegim të qartë dhe të elaboruar të problemit, arsyetimin e aspektit klimatik, qëllime të projektit dhe rezultate që priten të përkufizuar mirë (me shumë koherencë);
- Ekip i subjekteve zbatues me përvojë më shumë se 5 vite në menaxhimin me projekte të llojit të ngjashëm (madhësi dhe shpenzime të ngjashme) dhe mbi 2 projekte të ngjashëm të zbatuar;
- Projekt-ide afatagjate (mbi 8 vite)
- Projekt-idetë që ofrojnë mbështetje të lartë në arritjen e qëllimeve të BE-së në më shumë se 3 kapituj të bisedimeve të BE-së (p.sh. Kapitulli 27 – Mjedisi, Kapitulli 14 – Transporti, Kapitulli 15 – Energjia, etj...)
- Projekt-Idetë që nxisin mbi 3 QZhQ (p.sh., QZhQ 1 – Varfëria, QZhQ 13 – Ndryshimet klimatike, QZhQ 4 – Arsimi dhe promovimi i mundësive për nxënie të përhershme, etj.)
- Projekt-idetë në përputhje të plotë dhe koherente me politikat për ndryshimet klimatike, strategjitë dhe prioritetet (njohuri të larta të kontekstit të ndryshimeve klimatike, strategjive, politikave dhe përgatitjes së mirë para fillimit të përpilimit të Projekt-ideve janë më se të domosdomshme)
- Projekt-idetë me ndikim shumë të lartë të zbutjes/përshtatjes (duke përfshirë aspektin gjinor dhe grupet e cënueshme).

4.3 Plani indikativ për vlerësim të Projekt-ideve

Afatet indikative për dorëzim dhe vlerësim/prioritetizim të projekt-ideve jepen në grafikon më poshtë.



Afati i fundit për dorëzim të Dokumentit të plotë të Projekt-idesë nga ana e aplikantëve është 15 dhjetori 2019 (16:00 h)

Keni pyetje? Vizitoni:

www.greendevlopmnet.mk

SHTOJCA 1 Sektorët prioritarë nacionalë dhe aktivitetet prioritarë për zbutje dhe përshtatje

<p>Dokumenti strategjik nacional</p> <p>RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DYMJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)</p> <p>Lidhja tek dokumenti</p> <p>http://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b0db60edb04522ec50e97d2881f1ef56eec77c5090.pdf</p>		
	Gëllimi i zbutjes	Përkrahimi i aktivitetit të zbutjes
Energjia - Industrië e energjisë	Ulja e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ngrohjes	Masat operative dhe konstruktive të nevojshme për ulje të humbjeve, implementuar nga operatorët e rrjeteve shpërndarëse.
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtim i hidrocentraleve të rinj të mëdhenj
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtim i hidrocentraleve të rinj të vegjël dhe futja në përdorim e tarifave fleksibile të shitjes për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtim i centraleve diellore (me më shumë se 10 kE) dhe futja në përdorim e tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtimi i centraleve diellore në kulme dhe futje në përdorim e "matjes neto"
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtimi i centraleve me erë dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtimi i centraleve me biogas dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit shtëpiak të gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Ndërtim i centraleve që prodhojnë me biomasë (me CHP opsionale) dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin

<p>Dokumenti strategjik nacional</p> <p>Lidhja tek dokumenti</p>	<p>Gëllimi i zbutjes</p>	<p>Përshkrimi i aktivitetit të zbutjes</p>
<p>RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DYVJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)</p> <p>http://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b0db60adb04522ec50e97d2881fef56eec77c5090.pdf</p>	<p>Përdorim i nxehtësisë të panevojshme nga REK Manastiri</p> <p>Ulje e varshmërisë nga impporti dhe përdorim më i madh i sistemit të tubacionit të gazit</p> <p>Arritja e synimeve të caktuara tek Plani i Veprimit për Efikasitet Energjetik dhe Plani i Veprimit për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë</p> <p>Penëtrimi i pajisjeve me efikasitet më të lartë (klasi A++, A+, A, B) dhe plotësimi i synimit cakuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik</p> <p>Përdorim më efikas i energjisë elektrike me qëllim të arritjes së synimit të caktuar tek Plani i Veprimit për Efikasitet Energjetik</p> <p>Rritja e vetëdijes së opinionit mbi rëndësinë dhe përfitimet nga blerja dhe përdorimi i pajisjeve me klas të lartë të efikasitetit me qëllim të arritjes së synimit të caktuar tek Plani i Veprimit për Efikasitet Energjetik</p> <p>Rinovimi i ndërtesave ekzistuese për banim me qëllim të arritjes së synimit të caktuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik</p>	<p>Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore në Manastir dhe përdorim i nxehtësisë së tepërt nga REK Manastiri</p> <p>Ndërtimi i centraleve me gas natyral (CHP)</p> <p>Instalimi i kolektorëve diellorë termalë për ujë të nxehtë</p> <p>Etiketimi i aparateve elektrike dhe pajisjeve për të ofruar informata relevante mbi shpenzimin e energjisë elektrike të produkteve.</p> <p>Heqja nga përdorimi i pajisjeve për ngrohje me ngrohës rezistentë dhe zëvendësimi i tyre me pompa të nxehtësisë në përputhje me Politikën e BE-së për Klimë dhe Energji</p> <p>Krijimi i qendrave informative EE nëpër vetëqeverisjet lokale ose Qendrat e planifikimit rajonal, ku do punojnë këshilltarë energjetikë duke dhënë këshilla falas për qytetarët e interesuar lidhur me mundësitë për kursim të energjisë dhe kursimit të parave në shtëpitë e tyre</p> <p>Rinovim i ndërtesave për banim duke përfshirë ndërrimin e dritareve, me iniciativë të pronarëve dhe/ose me mbështetje të bankave komerciale dhe fondeve që ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut</p>

**Energjia -
Prodhim dhe
ndërtim**

Dokumenti strategjik nacional

RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DRYJËÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)

Lidhja tek dokumenti

<http://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b60edb04522ec50e97d2881f1ef56ee77c5090.pdf>

	Gëllimi i zbutjes	Përkrimi i aktivitetit të zbutjes
Energjia – Prodhim dhe ndërtim	Rinovim i objekteve ekzistuese publike me qëllim të arritjes së synimit të caktuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik	Rinovim duke përfshirë ndërtimin e dritareve në objektet publike nën juridiksion qendror ose të vetëqeverisjes lokale.
	Rinovim i objekteve ekzistuese komerciale me qëllim të arritjes së synimit të caktuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik	Rinovim i objekteve ekzistuese komerciale duke përfshirë ndërtimin e dritareve, me iniciativë të pronarëve dhe/ose me mbështetje të bankave komerciale dhe fondeve që ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut
	Ndërtim i objekteve të reja me qëllim të arritjes së synimit të caktuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik	Ndërtim i objekteve të reja në përputhje me Rregulloren për performancën energjetike të objektit.
	Plotësim i kërkesave të Direktivës së BE-së 2010/31/EU që të gjitha objektet e ndërtuara pas 31.12.2020 të jenë objekte pothuajse me zero-energj	Ndërtim i objekteve të reja pasive për banim në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/31/EU.
	Arritje e synimit të caktuar në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik	Zëvendësim i llambave inkandeshente me llamba halogjene (në fillim) dhe pastaj me kompakte fluoreshente (CFL) dhe LED
	Zëvendësimi i llambave ekzistuese me llamba sodiumi dhe LED	Zëvendësim i llambave ekzistuese me llamba sodiumi dhe LED

<p>Dokumenti strategjik nacional</p> <p>RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DRYJËÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)</p>		
<p>Lidhja tek dokumenti</p> <p>http://klimatekipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3ae04502b0bb60edb04522ec50e97d2881fef56ec77c5090.pdf</p>		
	<p>Qëllimi i zbutjes</p>	<p>Përkrahimi i aktivitetit të zbutjes</p>
	<p>Zbatimi i kriterëve me efikasitet energjetik ("gjelbërim") gjatë procedurave të prokurimeve publike</p>	<p>Aktivitetet të intensifikuara për të siguruar njohuri ligjore dhe teknike si dhe aftësi për subjektet në sektorin publik për përfshirje dhe vlerësim të kriterëve për efikasitet energjetik në procedurat e prokurimeve publike duke zbatuar kriteret për tenderat që kanë avantazh më të madh ekonomik</p>
<p>Energjia - Prodhim dhe ndërtim</p>	<p>Mundësim i qasjes tek lloji i ri i karburantit në sektorin publik rezidencial dhe atë komercial</p>	<p>Gasifikimi i sektorit publik rezidencial dhe komercial përmes ndërtimit të rrjetit të gasifikimit</p>
	<p>Ulja e ndotjes lokale</p>	<p>Përdorim i shtuar i sistemeve ekzistuese për ngrohje përmes zbatimit të fushatave informative për kycje të konsumatorëve të rinj, duke përfshirë ata që janë shkrycur nga sistemi në të kaluarën</p>
<p>Energy - Manufacturing and construction</p>	<p>Marrje e ujit sanitar të ngrohtë me përdorim të sistemit të ngrohjes në kombinim me kolektorët diellorë</p>	<p>Marrje e ujit sanitar të ngrohtë me përdorim të sistemit të ngrohjes në kombinim me kolektorët diellorë</p>
	<p>Zbatim i revizioneve të obligueshme energjetike për industrinë prodhuese dhe zbatim i standardit ISO 50001</p>	<p>Zbatim i revizioneve të obligueshme energjetike për industrinë prodhuese dhe zbatim i standardit ISO 50001</p>
	<p>Futja në përdorim e motorëve efikasë elektrikë në industrinë e prodhimit</p>	<p>Futja në përdorim e motorëve efikasë elektrikë në industrinë e prodhimit</p>

	Qëllimi i zbutjes	Përkrahimi i aktivitetit të zbutjes
	<p>Arritje e synimeve të caktuara në Planin e Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (deri në 2020 pjesa e karburanteve bio 5%)</p> <p>Arritje e synimeve të caktuara në Planin e Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (deri në 2020 pjesa e karburanteve bio 10%)</p> <p>Rritje e përdorimit të hekurudhës përmes rritjes së vetëdijes për përdorim të trenave për udhëtime të gjata dhe përmes përmirësimit të kushteve të kompanive</p> <p>Kjo masë përbëhet nga hapa të njëpasnjëshëm dhe të planifikuar mirë për përtëritje më të shpejtë të flotës së automjeteve</p>	<p>deri në 2020 pjesa e karburanteve bio 5%</p> <p>deri në 2020 pjesa e karburanteve bio 10%</p> <p>Rritje e përdorimit të hekurudhës përmes rritjes së vetëdijes për përdorim të trenave për udhëtime të gjata dhe përmes përmirësimit të kushteve të kompanive</p> <p>Kjo masë përbëhet nga hapa të njëpasnjëshëm dhe të planifikuar mirë për përtëritje më të shpejtë të flotës së automjeteve</p>
<p>Energjia në transport</p>	<p>Kjo masë përfshin miratimin e një rregullative që do mundësojë përtëritjen e flotës së automjeteve të lehta dhe atyre të rëndave për mallra dhe autobusëve</p> <p>Organizimi i fushatave/ofrimi i subvencioneve dhe sistemeve për përdorim të biçikletave të reja ose të marra me qira, ecjes, dhe futja në politikave për parkim që do ulin përdorimin e makinave në zonën e qytetit</p> <p>Lidhja e Republikës së Maqedonisë të Veriut me Republikën e Bullgarisë dhe zgjerimi i eksportit nëpër tregje të jashtëm, jo vetëm në vendet fqinje por edhe në Evropën Juglindore dhe në rajonin e Turqisë, përmes transportit hekurudhor</p> <p>Kjo masë përbëhet nga hapa të njëpasnjëshëm dhe të planifikuar mirë për përtëritje më të shpejtë të flotës së automjeteve, përmes futjes në përdorim të automjeteve elektrike</p>	<p>Kjo masë përfshin miratimin e një rregullative që do mundësojë përtëritjen e flotës së automjeteve të lehta dhe atyre të rëndave për mallra dhe autobusëve</p> <p>Organizimi i fushatave/ofrimi i subvencioneve dhe sistemeve për përdorim të biçikletave të reja ose të marra me qira, ecjes, dhe futja në përdorim e politikave për parkim që do ulin përdorimin e makinave në zonën e qytetit</p> <p>Ndërtimi i hekurudhës deri në Republikën e Bullgarisë</p> <p>Kjo masë përbëhet nga hapa të njëpasnjëshëm dhe të planifikuar mirë për përtëritje më të shpejtë të flotës së automjeteve, përmes futjes në përdorim të automjeteve elektrike</p>

<p style="text-align: center;">Dokumenti strategjik nacional</p> <p style="text-align: center;">RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DYVJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)</p>		
<p>Lidhja tek dokumenti</p> <p style="text-align: center;">http://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b0db60eb04522ec50e97d2881f1ef56ecc77c5090.pdf</p>		
	Gëllimi i zbutjes	Përshkrimi i aktivitetit të zbutjes
<p>Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi tjetër i tokës - Bagët</p>	<p>Ulje e nivelit të emetimit të CH4 nga fermentimi enterik tek lopët qumështore me produktivitet të lartë</p> <p>Ulje e nivelit të emetimit të NO2 nga menaxhimi me plehun organik tek lopët qumështore me produktivitet të lartë</p> <p>Ulje e nivelit të emetimit të NO2 nga menaxhimi me plehun organik tek feramat e derrave me produktivitet të lartë</p>	<p>Duke modifikuar përbërjen e ushqimit dhe praktikën e të ushqyerit tek lopët qumështore, emetimi i CH4 që vjen si rezultat i fermentimit enterik mund të ulet për 20%.</p> <p>Duke modifikuar menaxhimin e plehut organik tek lopët qumështore, emetimi i NO2 mund të ulet deri në 30%</p> <p>Duke modifikuar menaxhimin e plehut organik tek feramat e derrave, emetimi i NO2 mund të ulet deri në 50%.</p>
	<p>Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi tjetër i tokës - Pylltaria</p>	<p>Mbrojtje e zonës së pyjeve duke parandaluar zjarret në pyje dhe dëmet e shkaktuara nga zjarret në pyje</p> <p>Rritje e cilësisë së pyjeve përmes përzierimit të tokës transitive të pyjeve me specie të drurëve më cilësorë: gjethembajtës, gjetherënës dhe pyje të përziera</p>
<p>Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi tjetër i tokës - Përdorimi i tokës</p>	<p>Të ulet intensiteti i erozionit të tokës dhe humbja e masës organike të tokës</p> <p>Të ulet erozioni i shtresës së lartme të tokës dhe ruajtja e masës organike të tokës</p>	<p>Kultivimi i tokës në terren të pjerrët shkakton procese intensive të erozionit të tokës dhe mineralizim të masës organike të tokës.</p> <p>Kultivimi i tokës bujqësore të pjerrët zakonisht shkakton procese intensive të erozionit të tokës</p>
	<p>Ulje e erozionit të tokës dhe rritje e SOM tek vreshtat dhe tek kopshtet frutore në terren të pjerrët (tatëpjeta 5-15%)</p>	<p>Në vreshta dhe kopshte frutore nëpër lokacione ku rreshtet orientohen teposhtë, si rezultat i sistemit klasik intensiv të kultivimit, ndodhin procese intensive të erozionit të tokës dhe shterrje e SOM, që çojnë drejt emetimit intenziv të karbonit në tokë</p>

RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DYVJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)

Dokumenti strategjik nacional

Lidhja tek dokumenti

<http://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/554c445fec036e3de04502b0db60ecb04522ec50e97d2881fef56eec77c5090.pdf>

	Gëllimi i zbutjes	Përshkrimi i aktivitetit të zbutjes
Mbetjet - Largimi i mbeturinave të ngurta	Mbrojtje e mjedisit jetësor dhe plotësimi standardëve më të larta evropiane	Rehabilitim i deponive ekzistuese dhe deponive ilegale ("të egra") me rrezik shumë të lartë, të lartë dhe të mesëm në secilin nga gjashtë rajonet e për menaxhim me mbetjet. Mbyllje e deponive ekzistuese
	Mbrojtje e mjedisit jetësor dhe plotësimi i standardeve më të larta evropiane	Hapje e deponive të reja rajonale në të gjithë rajonet e menaxhimit të mbetjeve me sisteme të instaluar për trajtim mekanik dhe biologjik dhe kompostim. Trajtimi mekanik dhe biologjik (MBT) në deponi të reja me kompostim
	Vendosja e kontejnerëve për mbledhje të mbetjeve të selektuara, kryesisht letrës	Vendosja e kontejnerëve për mbledhje të mbetjeve të selektuara, kryesisht letrës. Klasifikimi i mbeturinave nga letra

Sektorë prioritarë të cënueshëm me potencial të lartë për përshtatje

Dokument i
strategjik
nacional

Lidhja tek
dokumenti

KOMUNIKIMI I TRETË MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2013)

http://unfccc.org/mk/content/Documents/TNP_ANG_FINAL.web.pdf

Sektorët prioritarë

Përshkrim i aktivitetit përshatës

Modifikim i sistemeve ekzistuese për furnizim me ujë dhe për ujtitje për të ulur humbjet e ujërave (pajisje matëse pikë-pikë, sprej mikro, me energji të ulët)

Zbatim i teknologjive për ripërdorim të ujit (komunal, drenazh, ujërat e zeza)

Inventar dhe regjistrim në harta GIS të puseve ekzistuese për përdorim të ujërave nëntokësore

Sistem ndërtimi për transfer ujqor ndër-pellgor

Hartim i planit për menaxhim me pellg lumor duke përfshirë lidhjen mes furnizimit tek ujërat sipërfaqësore dhe te ato nëntokësore

Harta GIS për rreziqe dhe menaxhim me rreziqet (thatisirat dhe vërshimet)

Përmirësim i rrjetit të monitorimit (ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, përdorimi i ujit, cilësia e ujit)

Hartim i planit të veprimit në raste vërshimi dhe futja në përdorim e Sistemit për Paralajmërim të Hershëm të Vërshimeve

Burimet e ujit

Sektorët prioritarë	Përshkrim i aktivitetit përshatës
	Krijimi i një fondi nacional për testim të masave përshatëse dhe prezantim i specieve që i rezistojnë thatësirave
	Subvencione për zbatim të masave përshatëse për fermerët profesionistë
	Zhvillim i një zgjedhjeje të re të shumëllojshme të kulturave dhe program eksperimental për rritje të përshatjes së kulturave ndaj ndryshimeve klimatike
	Krijim i një qendre nacionale për parashikim të periudhave të thata dhe atyre prodhuese Zhvillim i teknikave dhe procedurave për kultivim, përdorim të plenut artificial dhe bonifikimi i tokës për kulturat kryesore në zonat e prekura nga NK Zhvillim i praktikave të ndryshme të lëvrimit për të promovuar praktikat e qëndrueshme bujqësore.
	Zhvillim i teknikave për ujtiqe dhe furnizimit me ujë
Bujqësi - e përgjithshme	Zbatim i "Politikës për Karburantet Bio në Maqedoni", që do marrë parasysh përdorimin e karburantëve bio si alternativë për karburantet fosile në makinerinë bujqësore.
	Krijim i një rrjeti nacional për monitorim afatgjat të parametrave agro klimatikë dhe agro - edafik si parakusht për planifikim efikas dhe zbatim të masave përshatëse
	Zhvillim i kriterëve dhe identifikim i LUT dhe AEZ
	Krijimi i 15-20 fushave fenologjike dhe program financiar afatgjat
	Përfshirje e masave për përshatje në ndryshimet klimatike nëpër skemat për zhvillim rural
	Increased organic farming
	Increasing planting depth

<p>Dokumenti strategjik nacional Lidhja tek dokumenti</p>	<p style="text-align: center;">KOMUNIKIMI I TRETË MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2013)</p> <p style="text-align: center;">http://unfccc.org/mk/content/Documents/TNP_ANG_FINAL.web.pdf</p>
<p>Sektorët prioritarë</p>	<p style="text-align: center;">Përshtetja dhe aktiviteti përshatës</p> <p>Përforcim dhe ndryshime strukturore të Shoqatave dhe Korporatave për Përdorim të Ujërave.</p> <p>Mbështetje e bashkësive të Ujërave dhe ndryshime në sistemin e ngarkesës së ujit për ujti (në m3).</p> <p>Hartim i kriterëve dhe identifikim dhe planifikim i lokaliteteve me veçori specifike klimatike dhe të tokës për lloje të caktuara (terroir)</p> <p>Krijim i objekteve për procesim të mbetjeve bio për bio karburantët</p> <p>Krijim i një sistemi për paralajmërim të hershëm (rrjet i stacioneve meteorologjike) për dizinifikim më të mirë dhe efikasitet në përdorimin e ujërave</p> <p>Mbështetje e kërkimeve dhe inovacioneve për krijim dhe zgjerim të sistemeve dhe masave të reja të prodhimit</p> <p>Zbatim i sistemeve të reja për trajnim, në veçanti tek llojet e rrushit të tryezës (mbrojtje e rrushit nga djegia e diellit) dhe zbatim i prodhimit të integruar në vreshtari (përmirësim i dizinifikimit dhe efikasitet në përdorimin e plehrave artificiale)</p> <p>Mbështetje e krijimit të objekteve dhe logjistikës për prodhim të fidanëve të certifikuar dhe llojeve më rezistente ndaj shtypjeve klimatike.</p> <p>Krijim i zonave fenologjike në secilin nën-rajon të Povardarjes dhe program afatgjat financiar</p> <p>Mbështetje financiare për zbatim të masave moderne të përshatjes, si p.sh. rrjetat UV, mbulimi i kulturave, ujti me spërkatës</p> <p>Mbështetje financiare për zbatim të metodave dhe teknikave për rritje të efikasitetit në përdorimin e ujit, p.sh. sisteme të ujitjes me shtypje, sisteme kontrolli për ujti të planifikuar në mënyrë efektive, etj.</p> <p>Investime afatgjata në rindërtimin dhe zgjerimin e pendave dhe skemave të ujitjes.</p> <p>Mbështetje financiare për dislokimin e vreshtave në lartësi më të madhe dhe llojeve më të përshatshme/rezistente ndaj ngricave.</p> <p>Mbështetje financiare për intensifikimin e procesit të krijimit të vreshtave të reja (vetëm 2% e vreshtave rinovohen çdo vjet), për përmirësim të strukturës së vjetërsisë së vreshtave</p>
<p>Agriculture - viticulture</p>	

Sektorët prioritarë	Përshkrim i aktivitetit përshatës
Bujqësi – prodhimi blegtoral	<p>Fillimi i kultivimit të kafshëve për shumim me tolerancë gjenetike ndaj nxehtësisë</p> <p>Zbatim i ushqimeve speciale dhe teknikave të vecanta të ushqimit në periudhat me nxehtësi të tepërt</p> <p>Kushite më të mira për jetesë përmes përdorimit të ajrosjes së duhur, kondicionimit brenda-shtëpiak dhe instalimit të sistemeve ftohëse</p> <p>Futja në përdorim e monitorimit të vazhdueshëm të produktivitetit të fermave që pastaj mund të lidhet me valët e nxehta dhe temperaturat e larta për të siguruar përlogaritje të sakta të humbjeve</p> <p>Monitorimi i statusit të specieve të huaja (dhe invazive) të bimëve</p> <p>Monitorimi i statusit të specieve të kafshëve-vektorët e sëmundjeve</p> <p>Elaborimi i listës së specieve për të cilat konzervimi “eksitij” është akoma i nevojshëm</p> <p>Miratim i instrumenteve për politika për zbatim të planeve për menaxhim në planifikime hapësinore nacionale dhe rajonale</p> <p>Studimi i rastit i zbatimit të konceptit të rrjetit ekologjik në planifikimin rajonal duke u bazuar në qasje ndër-sektoriale</p>
Biodiversiteti	<p>Përshtatje e planeve për menaxhim të pyjeve në biokorridorët kryesorë të përdorimit të sigurt funksionalitet më të madh të tyre për sa i përket ndikimeve të ndryshmeve klimatike</p> <p>Studim i shpenzim-përfritimeve i ndikimit të sistemeve për prodhim të energjisë duke u bazuar në përdorimin e burimeve alternative të energjisë (sistemet hidrologjike, energjia diellore, era) mbi biodiversitetin</p> <p>Përkufizim i rrugëve të mundshme (biokoridoreve) për lëvizje dhe migrim të specieve të bimëve dhe kafshëve që janë nën kërcënim nga ndryshimet klimatike</p> <p>Përcaktimi i minimumit ekologjik për ekosistemet ujorë malorë</p> <p>Studim hidrologjik për cënueshmërinë e kënetave në vende të rrafshëta, moçaleve malore dhe liqeneve akullnajore</p>

<p>Dokumenti strategjik nacional Lidhja tek dokumenti</p>	<p style="text-align: center;">KOMUNIKIMI I TRETË MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2013)</p> <p style="text-align: center;">http://unfccc.org/mk/content/Documents/TNP_ANG_FINAL_web.pdf</p>
<p>Sektorët prioritarë</p>	<p style="text-align: center;">Përshkrim i aktivitetit përshatës</p> <p>Vlerësim i ndikimit të lëkundjeve periodike hidrologjike natyrale ose të shkaktuara mbi biodiversitetin e liqeneve akullnajore në kontekst të ndryshimeve klimatike</p> <p>Vlerësim i ndikimit të lëkundjeve periodike hidrologjike natyrale ose të shkaktuara mbi biodiversitetin e moçaleve malorë dhe burimeve në kontekst të ndryshimeve klimatike</p> <p>Vlerësim i ndikimit të lëkundjeve periodike hidrologjike natyrale ose të shkaktuara mbi biodiversitetin e moçaleve në vende të rrafshëta dhe kënetave në kontekst të ndryshimeve klimatike</p> <p>Vlerësim i ndikimit të vërshimeve të induktuara mbi shkurret Tamaris, pyjet me shegje me plepa dhe Periploca në rajonin e Gjevgjeliësë</p> <p>Studim i linjës historike dhe të tashme të kufirit pyjor dhe modelimi i ndryshimeve në të ardhmen që do shkaktohen nga klima</p> <p>Planifikim i detajuar dhe modelim i ndryshimeve në disa lloje të kullotave malore si studim pilot mbi ndryshimet klimatike</p> <p>Rishikim i detajuar i sistemit të zonave të Mbrojtura në Maqedoni lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Themelimi i një organi inter-sektorial tek administrata me përgjegjësi për menaxhim të burimeve të ujërave dhe biodiversitetit, me strategji për aktivitetet</p>
<p>Biodiversity</p>	

Sektorët prioritarë	Përshkrim i aktivitetit përshtatës
	Përgatitje dhe hartim i Strategjisë Rajonale për NK për Përshtatje në Shëndetësi
	Krijim i Komisionit Rajonal Ndërsektorial për NK për monitorim të procesit përshtatës ndaj ndryshimeve klimatike
	Rritje e aktiviteteve momentale lidhur me shëndetin publik në rajon
	Edukim dhe trajnim i profesionistëve në fushën e shëndetësisë për trajtim/menaxhim me ndikimet nga NK dhe masa për përshtatje në ndërtimin e kapaciteteve në sektorin e shëndetësisë
Hshëndeti njerëzor	Krijim i mbledhjes së informatave dhe të dhënave + hulumtim mbi efektet shëndetësore të NK në rajon të theksuara në këtë studim duke përfshirë edhe ato me të dhëna të kufizuara ose pa të dhëna
	Studime hulumtuese mbi shpenzimet e dëmeve dhe efektet në shëndet si dhe përfitim në shpenzim nga masat për forcim të kapaciteteve për përshtatje;
	Krijim i sistemit të integruar të të dhënave për paralajmërim të hershëm mbi NK dhe monitorim të shëndetit duke përfshirë edhe krijimin e monitorimit të ndotjes së ajrit + krijim dhe mirëmbajtje e bazës së të dhënave mbi NK lidhur me shëndetin
	Parandalim i efekteve ose ulje e rrezoqeve- hartim i planeve për përshtatje dhe ripërteritje nëpër institucionet shëndetësore + ndërtim i aftësive ripërtëritëse: Të bëhet plotësimi i planeve ekzistuese për indeks të sigurisë nëpër Spitale dhe planeve për përgatitje në raste të katastrofave
	Rritja e cilësisë (dhe sasisë) së ujit të pijshëm në veçanti në zonat rurale
	Themelimin/përmirësim i sistemit efikas për kontroll të sigurisë së ushqimit dhe zbatim i HACCP në çdo nivel të prodhimit të ushqimit, transportit dhe marketingut duke përfshirë edhe bazën e të dhënave për siguri të ushqimit rajonal që do jetë transparente dhe do azhurnohet rregullisht

<p>Dokumenti strategjik nacional Lidhja tek dokumenti</p> <p>KOMUNIKIMI I TRETË MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2013)</p> <p>http://unfccc.org.mk/content/Documents/TNP_ANG_FINAL.web.pdf</p>	
<p>Sektorët prioritarë</p>	<p>Përshkrim i aktivitetit përshatës</p> <p>Rritje e të kuptuarit të ndikimeve negative që ndryshimet klimatike mund të kenë mbi trashëgiminë kulturore</p>
	<p>Vlerësim i cënueshmërisë së trashëgimisë ndërtimore dhe asaj arkeologjike si dhe paisazheve kulturore historike përmes vlerësimit të shpejtë të ndikimit</p>
<p>CTrashëgimia kulturore</p>	<p>Krijim i një programi monitorimi për dëme në trashëgimi ndërtimore dhe arkeologjike si dhe paisazhe kulturore historike gjatë kushteve të motit ekstrem që zgjat shkurt dhe ndryshimeve afatgjata klimatike</p>
	<p>Identifikimi i mjeteve dhe masave për përshatje për kategoritë kryesore të trashëgimisë kulturore</p> <p>Kufizimi i dëmeve përmes zbatimit të strategjive afatgjata të menaxhimit që lidhen me përshatjen e ndikimeve që ndryshimet klimatike kanë mbi trashëgiminë</p>